



Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ Prishtinë/Priština, Kosovo | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

Raporti vjetor 2012



Parathënie

Ky ishte viti i pestë i aktiviteteve të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Sikurse në vitin 2011, Paneli nxori shumë vendime dhe mendime të rëndësishme, duke përfshirë edhe disa që shtrihen në praktikën e tij të mëparshme gjyqësore. Në këtë raport, rastet janë paraqitur hollësisht.

Viti 2012 ishte viti i parë nga fillimi i aktivitetit të Panelit kur puna e stafit ligjor dhe administrativ të Sekretariatit të PKDNJ nuk u pengua nga mungesa e stafit dhe numri i madh i lëndëve të parashtruara në ekipin e zyrtarëve ligjorë (probleme që janë theksuar disa herë më parë). Në situatë ideale do të caktoheshin më shumë avokatë për të punuar në Sekretariat; mirëpo, nëse ekipi i cili u bashkua në mënyrë të suksesshme në vitin 2012 mbete në përbërje të plotë, është parashikuar që ky grup i vogël por shumë profesional dhe jashtëzakonisht i devotshëm të shqyrtojë në mënyrë të shpejtë dhe cilësore ankesat e mbetura. Njëri prej kushteve të nevojshme për ta mbajtur këtë ekip kompakt është financimi i jashtëm, deri tani i siguar nga Qeveria e Suedisë, për të cilën ne jemi jashtëzakonisht mirënjohës. Nëse ndihma e ngjashme nuk do të ishte më në dispozicion, Paneli pret një reagim të duhur nga ana e UNMIK-ut që ne do të na mundësonte të mbajmë stafin aktual.

Në përgjithësi, bashkëpunimi me UNMIK-un për rastet që janë duke u proceduar është mjaft i mirë. Paneli ka pranuar komentet dhe informacionet e kërkuara me kohë. Zëvendësimi i ish anëtarët të Panelit, z. Paul Lemmens me anëtarin aktual të Panelit znj. Françoise Tulkens është bërë shumë qetë për shkak të veprimeve të kujdesshme të PSSP-së dhe të Kryetarit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Mirëpo, mungesa e reagimeve të duhura dhe me kohë nga ana e PSSP-së, ashtu siç kërkohet me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 për mendimet dhe rekomandimet e Panelit vazhdon të jetë problem. Situata në këtë aspekt është larg nga të qenit e kënaqshme dhe duhet përmirësuar.

Problemi më i rëndë i pazgjidhur në rastet që trajtohen nga Paneli vazhdon të jetë mungesa e vullnetit në kuadër të sistemit të KB-së për të siguar kompensimin përkatës dhe reparacione të tjera për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut të gjetura nga Paneli. Edhe pse kanë kaluar vite, situata nuk ka lëvizur. Paneli nuk është në dijeni për fakte që tregojnë se janë ndërmarrë aktivitete materiale në këtë aspekt. Rekomandimet e Panelit, veçanërisht ato të cilat u referohen kompensimit financiar, janë duke u injoruar kurse viktimat lihen vetëm me kënaqësinë se Paneli ka përligjur kërkesat/ankesat e tyre. Kjo pa dyshim se është shumë pak dhe bashkohet me faktin se një mendim i Panelit me të cilin gjinden shkelje as nuk zbatohet me një letër kërkimfaljeje drejtuar viktimës nga PSSP-ja në emër të UNMIK-ut.

Mu sikurse në vitet paraprake, Paneli efektivisht ka mundur të llogarisë në bashkëpunimin nga institucionet e ndryshme që veprojnë në Kosovë. Këtu përfshihen agjencitë ndërkombëtare dhe vendore siç janë Agjencia Kosovare e Pronës, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, Prokuroria publike e qarkut në Prishtinë, si dhe gjykatat e rregullta. Shqyrtimi i një numri të rasteve do të ishte shumë më i vështirë ose madje edhe i pamundur pa një bashkëpunim të tillë për shkak të informacioneve të pamjaftueshme të pranuar nga ankuesit ose nga UNMIK-u.

Gjatë vitit të kaluar, Paneli ia kushtoi shumicën e kohës ankesave me të cilat pohoj se UNMIK-u dështoi në zbatimin e hetimeve të duhura dhe efektive për rastet e njerëzve të humbur apo të vrarë në Kosovë në vitin 1998-2000. Paneli i përqendroi përpjekjet e tij për të siguruar që në vitin 2012, të gjitha rastet e tilla, d.m.th. mbi 200, të shqyrtoheshin sa i përket pranueshmërisë së tyre. Në praktikë, Paneli e arriti këtë qëllim; të gjitha ankesat e tilla janë shpallur të pranueshme. Në procedurat e mëtejshme lidhur me këto raste, pas plotësimit të dëshmive materiale, Paneli filloi me përgatitjen e mendimeve për bazueshmërinë e tyre, i pari nga të cilët u shpall në dhjetor. Të tjerët do të pasojnë me sukses gjatë sesioneve të Panelit në vitin 2013.

Marek Nowicki

Kryetar

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

mars 2013

Përmbajtja

1. Hyrja	1
2. Përbërja e Panelit	2
2.1. Anëtarët e Panelit	2
2.2. Anëtarët e Panelit që shërbyen në vitin 2012	4
2.3. Stafi i Sekretariatit	5
3. Korniza rregullative	6
4. Uebsajti i Panelit.....	7
5. Ngarkesa me lëndë e Panelit dhe statistikat	8
5.1. Statistikat.....	8
5.2. Mendimet dhe vendimet e Panelit sipas çështjes së trajtuar	8
6. Tendencat dhe çështjet që vlen të theksohen	10
7. Praktika gjyqësore e Panelit.....	13
7.1. Çështjet e pranueshmërisë	13
7.2. Çështjet përmbajtëse.....	16
7.2.1. E drejta për jetë – Neni 2 i KEDNJ	16
7.2.2. E drejta për liri – Neni 5 i KEDNJ	18
7.2.3. E drejta për të respektuar jetën private dhe familjare – Neni 8 i KEDNJ.....	18
7.2.4. E drejta për gjykim të drejtë – Neni 6 § 1 i KEDNJ.....	18
7.2.5. E drejta për mbrojtje të pasurisë – Neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ dhe e drejta për mjet të efektshëm – Neni 13 i KEDNJ.....	19
7.2.6. E drejta për qasje në shërbimet publike dhe e drejta për mjet të efektshëm – Neni 2 § 3 i KNDCP, lidhur me nenin 25(c) të KNDCP.....	20
8. Rekomandimet e Panelit	21
9. Mungesa e reagimeve publike të UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit.....	22
10. Lista e anekseve	24
Aneksi A: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12	25
Aneksi B: Urdhëresa administrative e UNMIK-ut 2009/1	32
Aneksi C: Tabela statistikore e PKDNJ	35
Aneksi D: Lista e vendimeve dhe mendimeve të PKDNJ të Nxjerra më 2012.....	36
Aneksi E: Vendimet dhe mendimet e miratuara të PKDNJ, sipas vitit	41
Aneksi F: Rastet e mbyllura të PKDNJ (të papranueshme, të hedhura poshtë dhe mendimet për bazueshmërinë) sipas vitit	41
Aneksi G: Shkurtesat dhe akronimet	42

1. Hyrje

1. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli), i themeluar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të datës 23 mars 2006¹, ka vazhduar shqyrtimin e ankesave për shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) apo ato që i atribuohen atij gjatë vitit të pestë të funksionimit të tij në Prishtinë, Kosovë. Paneli mbetet mekanizimi i vetëm që merret me shkeljet e të drejtave të njeriut që pretendohet se janë bërë nga Misioni i Kombeve të Bashkuara apo që i atribuohen atij.

Edhe pse Paneli nuk mund të urdhërojë kompensim ose ndihmë specifike, ai megjithatë mund të vendosë nëse UNMIK-u është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe, nëse është, mund t'i bëjë rekomandime Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara (PSSP) në Kosovë.

2. Me konstituimin e tërësishëm të Panelit në vitin 2011, ai arriti vitin më të suksesshëm deri më sot në procedimin e ankesave. Ky Raport vjetor mbulon periudhën prej 1 janarit 2012 deri në fund të 31 dhjetorit 2012, gjatë së cilës kohe Paneli ka mbajtur 11 seanca, nuk ka pranuar ankesa të reja,² dhe i ka komunikuar 73 raste PSSP-së për komentet e tij mbi pranueshmërinë, dhe i ka dërguar 172 raste PSSP-së duke kërkuar komentet e tij për bazueshmërinë e ankesave. Gjatë vitit 2012, Paneli gjithashtu miratoi 9 mendime mbi bazueshmërinë (lidhur me 23 ankesa), tutje konstatoi pranueshmërinë e 73 ankesave ose pranueshmërinë e pjesëshe, shpalli 66 ankesa të papranueshme dhe hoqi nga lista e rasteve në pritje 6 ankesa. Nga një numër i përgjithshëm i 527 ankesave të regjistruara, disa prej të cilave kishin të bënin me një numër të madh të ankuesve për të cilët ishin dhënë emrat, një numër i përgjithshëm prej 257 janë raste të mbyllura, derisa pjesa e mbetur prej 270 ankesave janë në pritje për shqyrtim në faza të ndryshme të procedurës. Në vitin 2012 Paneli nxori vendime dhe mendime për 270 raste, me një rritje prej 27 % krahasuar me 2011. Paneli është akoma në pritje të përgjigjes publike të UNMIK-ut për të gjeturat dhe rekomandimet që i ka bërë Paneli deri më sot.

3. Në vitin 2012, Paneli dhe Sekretariati kanë marrë fonde nga Qeveria suedeze për të vazhduar mbështetjen për një avokat shtesë për një periudhë prej 12 muajsh, kontrata e të cilit u menaxhua nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Paneli është mirënjohës që Qeveria suedeze më vonë u pajtua që të shfrytëzojë pjesën e mbetur të parave të grantit njëvjeçar për të financuar avokatin edhe për një periudhë trevjeçare në vitin 2013, sërish nën menaxhimin e UNDP-së. Përveç kësaj, Divizioni i UNMIK-ut për Mbështetjen e

¹ Bashkëngjitur si aneksi A.

² Në pajtim me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, afati kohor i pranimit të ankesave nga Paneli përfundoi më 31 mars 2010.

Misionit e kanë përtërirë kontratën me Sekretariatit për shërbime nga jashtë të përkthimeve jokonfidenciale, për të zvogëluar grumbullin e materialeve që duhet të përkthehen.

4. Në emër të Panelit, Sekretariati vendosi lidhje me Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, me Amnesty International, me Human Rights Watch dhe me projektin për ndihmë juridike “Mbështetje e mëtejshme për refugjatët dhe PZHBV në Serbi”. Përveç kësaj, Sekretariati u mbajti prezantime studentëve vizitorë nga Qendra evropiane për studime të magjistraturës mbi të drejtat e njeriut dhe demokratizimin, e vendosur në Venecie. Për të perfeksionuar më shumë ekspertizën për lëndët në kompetencë të Panelit, avokatët nga Sekretariati vizituan Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg të Francës, ku ata vendosën kontakt me avokatë e gjykatës të cilët specializohen për raste që kanë të bëjnë me personat e zhdukur dhe/ose të vrarë, ose për raste të tjera të cilat përkojnë me lëndët e ankesave të parashtruara pranë Panelit. Këto takime u dëshmuar jashtëzakonisht produktive për Sekretariatit, meqë informacionet e këmbëryera në mes të avokatëve nxorën në pah natyrën e ngjashme të praktikës gjyqësore të dy institucioneve.

2. Përbërja e Panelit

2.1. Anëtarët e Panelit

5. Tre anëtarët e Panelit, të cilët janë emëruar nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe janë (ri)emëruar nga PSSP-ja në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/12, nga 1 janari 2012 janë z. Marek Nowicki (Poloni), z. Paul Lemmens (Belgjikë). Znj. Christine Chinkin (Mbretëria e Bashkuar/Australi). Më 13 shtator 2012, z. Paul Lemmens i cili kishte shërbyer si anëtar i Panelit që nga themelimi i tij në janar të vitit 2007, dha dorëheqje nga pozita e tij për t’ju bashkuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si gjyqtar i zgjedhur nga Belgjika. Më 13 shtator 2012, PSSP-ja emëroi znj. Françoise Tulkens, ish nënkryetare e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si pasardhës të tij. Paneli zgjodhi z. Marek Nowicki Kryetar në janar të vitit 2008 dhe e rizgjodhi atë në po të njëjtën pozitë në vitin 2009, 2010, 2011 dhe 2012³.
6. Më tutje në tekst janë të dhënat biografike të anëtarëve të Panelit.
7. **Marek A. Nowicki** (janar 2007 – vazhdon) është shtetas i Polonisë, avokat në fushën e të drejtave të njeriut dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Varshavës që nga viti 1987.
8. Z. Nowicki ishte Avokati ndërkombëtar i Popullit në Kosovë, i emëruar nga Kombet e Bashkuara nga korriku i vitit 2000 deri në dhjetor 2005. Ai ka qenë anëtar i Komisionit

³ Rregullorja e Punës së PKDNJ (HRAP), Rregulla 6.

evropian për të drejtat e njeriut në Strasburg nga marsi 1993 deri më 31 tetor 1999, dhe po ashtu ka qenë anëtar i Polonisë në Rrjetin e Bashkimit Evropian të ekspertëve të pavarur për të drejtat themelore, nga marsi 2003 deri në shtator 2006. Në vitin 2005 ai është emëruar nga Komisioni i ministrave si njëri prej kandidatëve për postin e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës.

9. Ai ishte njëri nga “juristët eminentë” të emëruar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për të vlerësuar gjendjen ligjore dhe atë të të drejtave të njeriut në Moldavi (1994) dhe në Azerbejxhan (1997). Në vitin 1996 dhe 1998, Këshilli i Evropës kërkoi që ai të shërbejë si ekspert i të drejtave të njeriut gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së sistemit ligjor të Gjeorgjisë dhe të Federatës Ruse me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai ka punuar si ekspert i të drejtave të njeriut për Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) dhe për Drejtorinë e përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe çështjet ligjore të Këshillit të Evropës.
10. Z. Nowicki ka qenë themelues i Fondacionit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në Varshavë dhe kryetar i tij prej nëntorit 2003 deri në shkurt 2008. Aktualisht, ai e kryeson Këshillin Fondacionit. Ai është anëtar i Këshillit këshillëdhënës të Qendrës ndërkombëtare për mbrojtje ligjore të të drejtave të njeriut në Londër (INTERIGHTS). Z. Nowicki është autor i dhjetëra librave dhe i qindra artikujve për të drejtat e njeriut, të botuara në Poloni dhe në vendet tjera. Ai gjithashtu ligjëron për të drejtat e njeriut në universitetin “Collegium Civitas” në Varshavë.
11. **Christine Chinkin** (shkurt 2010-vazhdon), me shtetësi të dyfishtë britaneze/australiane, anëtare e Akademisë Britaneze, aktualisht profesoreshë e së drejtës ndërkombëtare në Fakultetin Ekonomik të Londrës, dhe profesoreshë e së drejtës globale William C Cook në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Michigan-it. Ajo është anëtare e Odës së Avokatëve të Anglisë dhe Wales dhe anëtare akademike e Matrix Chambers. Ajo është diplomuar në drejtësi në Universitetin e Londrës, Yale dhe Sidneit dhe më parë ka mbajtur poste akademike me orar të plotë në Universitetin e Oxford-it, të Londrës, Sidneit dhe Southampton-it, Fakultetin e Drejtësisë në Nju Jork dhe në Universitetin Kombëtar të Singaporit.
12. Interesimin kryesor znj. Chinkin e ka në të drejtën ndërkombëtare publike, veçanërisht ligji për traktatet, të drejtat e njeriut, duke e vënë theksin në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të grave dhe organizatave ndërkombëtare, dhe zgjidhjen e kontesteve vendore dhe ndërkombëtare. Ajo është autore e shumë artikujve për çështje të së drejtës ndërkombëtare publike dhe të drejtave të njeriut të grave, e ligjeve Halsbury të Australisë, E Drejta për Marrëdhënie të Jashtme (botimi i dytë 2001), Palët e Treta në të Drejtën Ndërkombëtare (1993), bashkautore në Zgjidhja e Kontesteve në Australi (botimi i dytë 2002), bashkautore e Kufijtë e së Drejtës Ndërkombëtare: Analizë femineiste (2000) dhe bashkautore e Krijimi i së Drejtës Ndërkombëtare (2007). Nga viti 2004-2012 ajo ka qenë drejtoreshë e Asociacionit për studime të së Drejtës Ndërkombëtare. Në prill 2001 ajo u shpërblye me fletëlavdërimin e Shoqërisë

- Amerikane të së Drejtës Ndërkombëtare për 'kontribut të jashtëzakonshëm në arritjen e diturisë' dhe në vitin 2006 Medaljen e Shoqërisë Goler T. Butcher 'për kontribut të jashtëzakonshëm për zhvillimin apo realizimin efektiv të ligjit për të drejtat e njeriut' (me H. Charlesworth).
13. Znj. Chinkin ka qenë konsulente e së drejtës ndërkombëtare për Bankën e Azisë për Zhvillim; për trafikimin e grave në Zyrën e Komisionerit të Lartë të KB-së për të Drejtat e Njeriut; për Marrëveshjet e Paqes dhe Çështjet Gjinore në Divizionin e KB-së për Avancimin e Gruas dhe për UNIFEM. Ajo ka qenë eksperte shkencore për një Komision ad hoc të Këshillit të Evropës për hartimin e një konvente për dhunën kundër gruas dhe dhunën në familje. Ajo ka qenë anëtare e Misionit për gjetjen e fakteve për Beit Hanoun, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara S 3/1, maj 2008, dhe Misionin e KB-së për gjetjen e fakteve në Konfliktin e Gazës në vitin 2009, dhe i Këshillit të të Drejtave të Njeriut DIBA të Misionit për sundimin e së drejtës në gjetjen e fakteve në Malawi në janar të vitit 2012.
 14. **Françoise Tulkens** (shtator 2012 - vazhdon) qytetare e Belgjikës, ka doktoruar në drejtësi, ka magjistruar në kriminologji dhe ka diplomuar në shkollën e lartë për mësimdhënie në fushën e drejtësisë (*agrégation de l'enseignement supérieur*). Ajo ka qenë hulumtuuese në Institutin Max Planck për të drejtën penale të jashtme dhe ndërkombëtare (Freiburg-im-Breisgau, Gjermani). Ka qenë profesoreshë në Universitetin Louvain (Belgjikë) dhe ka dhënë mësim në Belgjikë si dhe jashtë vendit – si profesor vizitues në Universitetin e Gjenevës, Montreallit, Otavës, Parisit I, Rennes, Strasburgut dhe në Universitetin shtetëror të Luizianës – në fushën e të drejtës penale (pjesa e përgjithshme), e drejta penale krahasimtare dhe evropiane, drejtësia për të mitur dhe sistemet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
 15. Nga nëntori 1998 deri më shtator 2012, ajo ka qenë gjyqtare në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke shërbyer si kryetare e sektorit dhe nga janari 2007 dhe si nënkryetare e Gjykatës nga shkurti 2011.
 16. Znj. Tulkens është autore e shumë publikimeve në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtës penale dhe gjithashtu është bashkautore e librave të referencës: *Introduction au Droit Pénal: Aspects Juridiques et Criminologiques* (edicioni i 9-të, 2010) dhe *Droit de la Jeunesse : Aide, Assistance et Protection* (2000). Ajo është anëtare e bordit editorial të një sërë revistash shkencore, në mesin e të cilave *Revue Trimestrielle des droits de l'homme*, *Journal des Tribunaux-droit européen*, *Revista e drejtësisë ndërkombëtare penale* dhe *Revista ndëramerikane dhe evropiane e të drejtave të njeriut*.
 17. Ajo është pjesë e shumë asociacioneve dhe, në veçanti, ajo është nënkryetare e Asociacionit ndërkombëtar për të drejtën penale, anëtare e Komitetit shkencor të institutit për të drejtat e njeriut në Odën e avokatëve të Brukselit dhe në Bordin e administruesve të besuar në Akademinë e legjislacionit evropian.

18. Ajo ka marrë doktoratë nderi nga Universiteti i Gjenevës, Limoges dhe Otavës. Ajo ka qenë anëtare pjesëmarrëse në Akademinë Mbretërore të Shkencave, Literaturës, dhe Arteve Figurative të Belgjikës që nga viti 2011.
19. Znj. Tulkens aktualisht është kryesuese e Bordit të guvernatorëve të Fondacionit të mbretit Baudouin.

2.2. Anëtarët e Panelit që shërbyen në vitin 2012

20. **Paul Lemmens** (janar 2007- shtator 2012) është shtetas i Belgjikës. Ai ka qenë gjyqtar në Këshillin shtetëror të Belgjikës, nga viti 1994 deri në shtator 2012. Ai ka shërbyer në sektorin e Këshillit shtetëror që shqyrton përputhshmërinë e propozim-legjislacionit dhe propozim-rregulloreve me normat më të larta të së drejtës vendore dhe ndërkombëtare, si dhe në sektorin e së drejtës kontestimore të Këshillit shtetëror, e cila përbën Gjykatën Supreme Administrative të Belgjikës.
21. Që nga viti 1986, z. Lemmens po ashtu ka qenë profesor në Universitetin e Leuvenit, ku ligjëron të drejtën ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Ai gjithashtu ka ligjësuar të drejtën kushtetuese, procedurën civile dhe atë administrative. Ai është autor i një numri librash dhe artikujsh për ligjet evropiane mbi të drejtat e njeriut. Ai ka qenë drejtor i Belgjikës në programin evropian të magjistraturës për të drejtat e njeriut dhe demokratizim, program evropian ndëruniversitar me bazë në Venecie të Italisë. Z. Lemmens mori mandatin e gjyqtarit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në shtator të vitit 2012.

2.3 Stafi i Sekretariatit

22. Stafi i Sekretariatit përbëhet prej një zyrtari ekzekutiv, tre zyrtarëve ligjorë dhe dy asistentëve administrative.
23. **A Andrey Antonov**, shtetas i Rusisë, ka filluar punën në Sekretariat në qershor 2011 si zyrtar ekzekutiv. Paraprakisht, z. Antonov ka punuar si hetues në Divizionin e Hetimeve në Zyrën për Kontroll të Brendshëm në KB (UN HQ) (2011), si zyrtar për sjellje dhe disiplinë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudan (2009-2011), si zyrtar ligjor në Zyrën e Integruar të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2008-2009), si zyrtar ligjor në Division Kriminal të Departamentit të Drejtësisë (DD) në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) (2005-2008), dhe si zyrtar ligjor në Sektorin për Integritet Gjyqësor në DD të UNMIK-ut (2003-2005). Para se të filloj punën në Kombet e Bashkuara, z. Antonov punoi në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Rusisë (MPB), në pozitën e hetuesit penal (Departamenti policor i transportit, Anapa, 1999) dhe ka pasur postin e ligjëruesit/ligjëruesit të lartë për lëndën Procedura penale dhe hetimi penal (Universiteti Krasnodar, MPB të Rusisë, 1999-2003). Në Kosovë për herë të parë arriti në vitin 2000 si pjesëtar i kontingjentit rus, i dërguar nga MPB të Rusisë për të shërbyer në Policinë e UNMIK-ut, ku ai punoi si zyrtar ligjor në Zyrën ligjore të Komisionerit të Policisë së UNMIK-ut deri në vitin 2002. Që nga viti 1999, z. Antonov ka doktoruar për drejtësi (PhD), i specializuar për

procedurën penale, hetimin penal dhe detektimin e krimit, në Akademinë Volgograd për drejtësi në MPB të Rosisë, dhe që nga viti 1996 ka magjistruar për drejtësi (LLM) në fushën e njëjtë ligjore, në vitin 1996 në Akademinë Volgograd për drejtësi në MPB të Rosisë. Përveç këtyre, ai është autor i më shumë se 30 publikimeve në botimet periodike të Rosisë që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të hetimeve penale.

24. **Anna Maria Cesano**, Anna Maria Cesano, shtetase e Italisë, filloi punën në Sekretariat në maj të vitit 2011 si specialiste për të drejtat e njeriut, e dërguar nga UNDP-ja dhe me financim të siguruar nga Qeveria suedeze. Paraprakisht, znj. Cesano punoi si zyrtare për sundimin e së drejtës në Programin për qasje në drejtësi të Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2010-2011), si zyrtare për ndërlidhje për Komisionerin e Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara në Tanzani (2009) dhe si zyrtare për të drejtat e njeriut në Zyrën e integruar të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2007-2009). Para fillimit të punës në Kombet e Bashkuara, znj. Cesano punoi në Universitetin Siena, Itali (2006-2007) si hulumtuese e sistemit evropian për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Znj. Cesano për herë të parë filloi punën në Ballkan në vitin 2005 në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, në Serbi dhe Mal të Zi. Ajo ka magjistruar për të drejtat e njeriut dhe menaxhimin e konflikteve në Universitetin Sant' Anna, studime të avancuara të Pisa, dhe ka magjistruar për drejtësi në Univeristetin Katolik në Milano, Itali.
25. **Brandon Gardner**, shtetas amerikan dhe ish anëtar i Odës së avokatëve të Pensilvanisë, filloi punën në Sekretariat në postin e zyrtarit ligjor në tetor 2011. Paraprakisht, z. Gardner ka punuar si këshilltar ligjor në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, në emër të Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, të vendosur në Kosovë (2009-2011). Para kësaj, z. Gardner ka punuar si zyrtar ligjor në Sektorin për marrëdhënie me jashtë në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut dhe në Zyrën ndërlidhëse të UNMIK-ut për sundimin e së drejtës (2007-2009). Z. Gardner ka punuar edhe si avokat në Pensilvani (2006-2007). Z. Gardner ka doktoruar në drejtësisë në Fakultetin e drejtësisë në Universitetin e Pitsburgut, dhe ka diplomuar në shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në Universitetin e Pitsburgut.
26. **Daniel Trup**, shtetas britanez/francez, ju bashkua Sekretariatit në qershor të vitit 2012 në postin e zyrtarit ligjor. Pasi u kualifikua si avokat në vitin 2000, z. Trup ka punuar në fushën e të drejtës penale në Mbretërinë e Bashkuar dhe jashtë. Para se t'i bashkohet Sekretariatit, z. Trup kishte punuar në Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë si zyrtar i lartë ligjor në Zyrën e prokurorisë speciale (2009-2012) dhe si zyrtar ligjor në Prokurorinë e Gjykatës shtetërore të Bosnjës dhe Hercegovinës (2008-2009). Z. Trup ka magjistruar në drejtësi në të drejtën ndërkombëtare në Universitetin Kent, dhe ka diplomuar në politikë dhe histori në Universitetin e Londrës.
27. **Snežana Martinović**, është punonjëse vendore, e cila punon si asistente administrative në Sekretariat që nga dhjetori 2007. Ajo ia filloi punën në Kombet e Bashkuara në prill të vitit 2000, si asistente administrative në Departamentin e Policisë së UNMIK-ut. Në

tetor të vitit 2002, ajo mori postin e asistente administrative në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut. Në mars të vitit 2012, posti i znj. Martinoviç u riklasifikua në asistente ligjore.

28. **Adlije Muzaqi**, është punonjëse vendore, e cila punon si asistente administrative në Sekretariat që nga shtatori 2010. Ajo ia filloi punës në Kombet e Bashkuara në tetor të vitit 1999 si asistente administrative në Administratën komunale të UNMIK-ut në komunën e Vushtrrisë, rajoni i Mitrovicësa.

3. Korniza rregullative

29. Teksti kryesor legjislativ për punën e Panelit mbetet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, përmes së cilës Panelit i jepen autorizimet për shqyrtimin e ankesave me diapazon të gjerë lidhur me shkeljen e drejtave të njeriut që pretendohet se janë bërë nga UNMIK-u duke u bazuar në instrumentet vijuese: Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut), Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Jonjerëzore dhe Poshtëruese dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Juridiksioni kohor i Panelit fillon nga 23 prilli 2005.⁴
30. Më 17 tetor 2009, PSSP-ja ka shpallur Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Përmes kësaj Urdhërese administrative ndryshohen kriteret për pranueshmëri, procedura për shqyrtimin e ankesave, mënyra e mbajtjes së seancave publike dhe procedura e emërimit për anëtarët e Panelit. Përmes kësaj Rregulloreje gjithashtu rregullohet mënyra e botimit të komunikatave për shtyp dhe e shpalljeve të Panelit. Kjo urdhëresë gjithashtu parasheh datën e fundit për paraqitjen e ankesave pranë Panelit. Kjo Urdhëresë administrative është diskutuar gjerë e gjatë në raportin e Panelit të vitit 2009 në §§ 35-45.
31. Procedura e Panelit përbëhet prej dy fazave kryesore⁵: e para ka të bëjë me shqyrtimin e pranueshmërisë, ndërsa faza e dytë me rastin e shpalljes së ankesës si të pranueshme dhe me shqyrtimin e bazueshmërisë së saj. Pranueshmëria përcaktohet përmes një vendimi formal, ku ceket edhe arsyetimi i tij. Në disa raste, Paneli fillimisht ka marrë vendim të pjesshëm për pranueshmërinë, dhe më pastaj në vendimin e formës së prerë janë përcaktuar çështjet e mbetura të pranueshmërisë, ose ato janë trajtuar bashkarisht me bazueshmërinë. Vendimet publikohen në faqen e internetit të Panelit pasi të jenë njoftuar palët në procedurë. Nëse Paneli shpall si të pranueshme tërë ankesën apo pjesë të caktuara të saj, pastaj fillon me shqyrtimin e bazueshmërisë së ankesës.

⁴ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, Neni 2.

⁵ Për përshkrime të mëtejshme të procedurës pranë Panelit, shih Raportin vjetor të Panelit të vitit 2009, i cili gjendet në: http://www.unmikonline.org/human_rights/documents/annual_report_2009.pdf 48-60.

32. Nëse ankesa vazhdon të shqyrtohet për bazueshmërinë e saj, Paneli paraqet mendimin e tij nëse ankuesit i janë shkelur të drejtat e njeriut që i atribuohen UNMIK-ut, i cili mund të përfshijë rekomandime drejtuar PSSP-së⁶. Pasi t'u jetë dhënë mendimi palëve, i njëjti gjithashtu publikohet në faqen e internetit të Panelit⁷. Nga ky moment, vetëm PSSP-ja ka autorizimin ekskluziv për të vendosur nëse do të veprojë në bazë të gjetjeve të Panelit.⁸ Vendimet e PSSP-së publikohen menjëherë në mënyrë që siguron shpërndarje dhe qasje të gjerë.

4. Uebajti i Panelit

33. Uebajti i Panelit⁹ është avancuar edhe më shumë në vitin 2012 për të mundësuar bashkëveprim më të mirë të përdoruesit dhe qasje më të lehtë në vendimet dhe mendimet e Panelit. Në uebsajt shënohen lëndët sipas emrit të ankuesit, ashtu që të mundësohet qasje në vendimet dhe mendimet e Panelit për ndonjë rast të caktuar. Përveç kësaj, Paneli po ashtu shënon çdo vendim dhe mendim të tij sipas numrit të lëndës dhe datës së miratimit, ashtu që personat e interesuar të mund të përcjellin zhvillimin e praktikës gjyqësore të Panelit. Nga viti 2012, në uebsajt gjithashtu paraqiten komentet e PSSP-së për rekomandimet e Panelit, duke mundësuar rishikimin e një vendimi të PKDNJ në secilën fazë të tij. Në uebsajt janë duke u shtuar edhe gjëra të tjera për të përmirësuar qasjen e shfrytëzuesit.

5. Numri i lëndëve në Panel dhe statistikat

5.1. Statistikat

34. Gjatë periudhës raportuese, nuk janë pranuar ankesa të reja, meqë 31 marsi 2010 ishte data e fundit për paraqitjen e ankesave të reja. Ndërmjet 2006 dhe 2010, Paneli ka pranuar gjithsej 527 ankesa¹⁰.

35. Gjatë periudhës raportuese, Paneli miratoi 9 mendime për bazueshmërinë (lidhur me 23 ankesa), konstatoi se 172 ankesa janë të papranueshme ose pjesërisht të pranueshme, shpalli 66 ankesa të papranueshme dhe 6 ankesa i largoi nga lista.

36. Në fund të vitit 2012 ishin 13 raste në pritje për shqyrtim nga Paneli në fazën e pranueshmërisë, dhe 257 raste ishin në pritje për mendim mbi bazueshmërinë¹¹. Paneli mbylli 95 raste në vitin 2012. Luteni t'i referoheni Aneksit C për statistika të detajuara.

⁶ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.1.

⁷ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.2.

⁸ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.3.

⁹ <http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Pages/default.aspx>

¹⁰ Ky numër ndryshon pak nga raportet e mëparshme meqë një ankesë është ndarë për arsye teknike.

¹¹ Në rastet kur kemi mendim të pjesshëm për bazueshmërinë, rasti është akoma në pritje për mendim të formës së prerë mbi bazueshmërinë. Gjithashtu, në vitin 2012, Paneli rihapi 2 raste që më parë ishin shpallur të papranueshme, *Balaj dhe të Tjerët* dhe *N.M. dhe të Tjerët*.

5.2. Mendimet dhe vendimet e Panelit sipas objektit të lëndës

37. Më poshtë janë një numër i zgjedhur i vendimeve dhe mendimeve të nxjerra në vitin 2012, të shënuara sipas objektit të lëndës që janë të nënvizuar për diskutim të mëtejshëm në pjesën 7 të këtij raporti:

E drejta për jetë – E drejta për hetime të efektshme – Ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor apo degradues

Mungesa e hetimeve të efektshme nga ana e UNMIK lidhur me rastet e personave të zhdukur/vrarë që lidhen me gjendjen e luftës

- *Radmila Tomić*, 160/09 (vendim i 5 prillit 2012)
- *Stevan Simović*, 246/09 (vendim i 6 prillit 2012)
- *Veska Majmarević*, 324/09 (vendim i 10 majit 2012)
- *S.C.*, 02/09 (mendim i 6 dhjetorit 2012)

Mungesa e hetimeve të efektshme nga ana e UNMIK lidhur me një rast ku është shkaktuar një vdekje në rrethana të dyshimta

- *Urosh Baraç*, 149/09 (vendim i 1 tetorit 2012)
- *R.A.*, 41/09 (vendim i 21 gushtit 2012)

E drejta për jetë – E drejta për hetime të efektshme – Ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor apo degradues – E drejta për liri

Mungesa e hetimeve të efektshme nga ana e UNMIK lidhur me një person të zhdukur/vrarë dhe rasti i mbajtjes së paligjshme që lidhet me gjendjen e luftës

- *Kostiç dhe të Tjerët*, 111/09 (vendim i 17 gushtit 2012)

Protestuesit e vrarë dhe të lënduar nga Policia e UNMIK-ut më 10 shkurt 2007

- *Kadri Balaj dhe të Tjerët*, 04/07 (vendim i 11 majit 2012)

Ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor apo degradues – E drejta për jetë private dhe familjare

Mungesa e hetimit të efektshëm nga ana e UNMIK-ut lidhur me një vrasje

- *Petar Jovičić*, 233/09 (vendim i 17 marsit 2012)

E drejta për posedim të papenguar – E drejta për gjykim të drejtë – E drejta për mjet të efektshëm – E drejta për të marrë vendim nga gjykata brenda një kohe të arsyeshme

Konfiskimi i pasurisë së mbrojtur private nga ana e UNMIK-ut

- *Jahja Morina*, 36/08 (mendim i 10 majit 2012)

Shkelja e kontratës nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës

- *Linda, LLC*, 45/08 (vendim i 22 gushtit 2012)
- *NTP Bujari (AS Petrol)*, 311/09 (vendim i 6 dhjetorit 2012)

Komisioni i ankesave për çështje banesore pronësore

- *Radislav Dekiç dhe Xhevahire Morina*, 36/09 dhe 37/09 (vendim i 21 gushtit 2012)
- *Miroslav Mihajloviç*, 15/08 (mendim i 22 gushtit 2012)

Agjencia Kosovare e Pronës

- *Nada Mladenoviç*, 61/10 (vendim i 6 prillit 2012)

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

- *Novica Jovanoviç dhe të Tjerët*, 28/10 & dhe të Tjerë (vendim i 20 janarit 2012)
- *Dragan Stojanoviç dhe të Tjerët*, 27/10 & dhe të tjerë (vendim i 17 shkurtit 2012)
- *Vesna Bojkoviç*, 40/10 (vendim i 16 marsit 2012)

Padi për përcaktimin e atësisë

- *Marija Laliç*, 31/08 (vendim i 9 qershorit 2012)

E drejta për qasje në shërbimet publike – E drejta për mjet të efektshëm

Largim nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës

- *Gani Thaçi*, 13/08 (mendim i 12 shtatorit 2012)

6. Tendencat dhe çështjet që vlen të theksohen

38. Disa tendenca në numrin e përgjithshëm të lëndëve dhe punës së Panelit kanë mbetur të njëjta, ndërsa të tjerat kanë ndryshuar dukshëm nga periudha e fundit raportuese. Në vitin 2012, Paneli e caktoi prioritet të parë miratimin e vendimeve për pranueshmëri për

një numër sa më të madh të rasteve të pohimeve për hetime të paefektshme për persona të zhdukur dhe/ose të vrarë (PZHV). Në praktikë kjo do të thotë se Paneli ka nxjerrë vendime mbi pranueshmërinë për 153 raste të PZHV në përgjithësi, dhe këto raste tani janë duke u shqyrtuar për bazueshmërinë e tyre. 150 nga këto raste janë shpallur të pranueshme në pajtim me obligimin procedural të nenit 2 të KEDNJ, dhe PSSP-ja rrallë ka paraqitur argumente kundër këtij vendimi.

39. Për të përmbushur detyrimin e procedimit të këtyre rasteve, Paneli zhvilloi metodologji të reja për klasifikimin dhe sistemimin e të dhënave. Këto përfshinin krijimin dhe shfrytëzimin e bazave të të dhënave të cilat përmbanin materiale relevante, si dhe harmonizimi i informacioneve të mbledhura nga bazat e të dhënave të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (KNPZH) dhe Zyrës së UNMIK/EULEX-it për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore (ZPZHML) për qëllimet specifike të Panelit.
40. Në dhjetor të vitit 2012, Paneli miratoi mendimin e tij të parë nga rastet e PZHV. Siç është diskutuar detajisht më poshtë (shih §§ 68-70), Paneli konstatoi se UNMIK-u e kishte shkelur obligimin procedural të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkak të mosefektivitetit të hetimeve të tij për rrëmbimin dhe vrasjen e të afërmeve të ankuesve. Duke u bazuar në praktikën ndërkombëtare, Paneli ka shtjelluar kriteret se çka përbën hetim të efektshëm dhe vendosi se performanca e Policisë së UNMIK-ut dhe e prokurorëve në këtë aspekt nuk i përmbushën standardet ndërkombëtare. Në rekomandimet e tij drejtuar UNMIK-ut, që në tërësi janë diskutuar më poshtë (shih §§ 85-86), në mesin e formave të tjera të reparacionit, Paneli sugjeroi që UNMIK-u formalisht t'u kërkojë falje ankuesve për shkeljen e detyrës së tij. Kjo formë e reparacionit është përkrahur nga Asambleja e Përgjithshme e KB-së, dhe shfrytëzohet nga Gjykata Ndër-amerikane për të Drejtat e Njeriut në mendimet e saj për PZHV. Në punën e mëtejme ky mendim i parë do të jetë i dobishëm si rast prijës për shumë raste të tjera të ngjashme.
41. Lidhur me këto raste, Paneli ka marrë një numër të konsiderueshëm të dosjeve të Policisë së UNMIK-ut, duke përfshirë edhe dosjet e fshehta të rasteve nga Selia e KB-së në Nju Jork, dhe dosje të tjera që kanë të bëjnë me hetimet për rastet e PZHV. Kjo i mundësoi Panelit të bëjë analiza më të thella të fakteve dhe rrethanave për këto raste të ndjeshme, duke pasur parasysh konfidencialitetin e tyre. Mirëpo, janë edhe një numër i rasteve të konsiderueshme për të cilat ka pasur pak ose aspak informacione në dispozicion në dosjet hetimore, ose nuk ka pasur fare dosje, duke ia vështirësuar punën Panelit për të vendosur nëse dosja është e plotë. Duke kërkuar vazhdimisht dosje nga UNMIK-u dhe nga kujdestari i tyre aktual, Misioni i EULEX-it në Kosovë, Paneli filloi me trajtimin e bazueshmërisë së këtyre rasteve në bazë të materialeve që aktualisht i posedonte. Në mendimin e tij të parë për PZHV, S.C., Paneli filloi të përgatisë konkluzionet që duhet të nxirren në rrethanat e tilla.
42. Një avancim tjetër që Paneli ka vërejtur gjatë vitit 2012 lidhur me rastet e PZHV është përgjigjja e UNMIK-ut lidhur me pranueshmërinë e të drejtës së ankuesve për të mos u trajtuar në mënyrë johumane, në veçanti e drejta për të mos pësuar vuajtje mentale dhe

dhimbje të shkaktuara nga zhdukja e një të afërmi (neni 3 i KEDNJ). Në vitin 2011 dhe në pjesën më të madhe të vitit 2012, UNMIK-u kundërshtoi pranueshmërinë e nenit 3 në këtë kontekst. Mirëpo, kah fundi i periudhës raportuese, UNMIK-u më nuk e kundërshtoi pranueshmërinë e nenit 3 në këtë aspekt për këto raste.

43. Një tendencë tjetër që vlen të potencohet është demonstruar në rastin *Morina*, të diskutuar detajisht më poshtë (§§ 76-78). Në rastin *Morina*, Paneli rekomandoi që ankuesit t'i paguhet kompensim për dëmin monetar dhe jomonetar, meqë ai në mënyrë bindëse kishte treguar se UNMIK-u ishte përgjegjës për konfiskimin e pasurisë së tij. Mirëpo, UNMIK-u e informoi Panelin, ashtu siç kishte thënë publikisht në rastin *Kusiç*, se “rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të KB-së nuk e lejojnë Organizatën apo misionet e saj të paguajnë kompensim tjetër përveç kompensimit për dëme materiale apo për lëndime fizike.”¹² Më dekurajues ishte mosreagimi publik i UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit lidhur me kompensimin: në vitin 2012, UNMIK-u e bëri publike vetëm pamundësinë e tij për t'u paguar kompensim viktimave si përgjigje në katër mendimet e Panelit, përkundër faktit se Paneli kishte nxjerrë më shumë se 20 mendime duke rekomanduar që UNMIK-u t'i paguaj viktimat. Kjo temë do të shtjellohet detajisht më poshtë (§§ 88-91). Mirëpo, vlen të theksohet se në një sërë rastesh, ankuesit kanë kërkuar nga PKDNJ t'i informojë ata se çka të bëjnë pas një mendimi të PKDNJ, me të cilin rekomandohet që UNMIK-u të paguaj dëmshpërblim; për momentin PKDNJ vetëm mund t'i informojë këta persona që direkt t'i drejtohen UNMIK-ut.
44. Gjithashtu, në vitin 2012, Paneli kishte dy kërkesa për rihapjen e procedurës, në rastet *Balaj dhe të Tjerët* dhe *N.M dhe të Tjerët*. Në të dy rastet, Paneli i kishte shpallur lëndët të papranueshme, por e kishin lënë të hapur mundësinë që ankuesit të kërkojnë nga Paneli rihapjen e procedurave të tyre pasi ata të kenë shterur procesin e KB-së për ankesa nga palët e treta, ashtu siç kërkohet me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1. Paneli ishte i kënaqur që ankuesit i kishin shterur mjetet e tyre juridike dhe vendosi të lejojë që të dy ankesat të rihapen. Paneli tani ka vazhduar me vlerësimin e bazueshmërisë për të dy ankesat. Për informacione të mëtejshme, shih §§ 60-61 më poshtë.
45. Paneli nxori më shumë vendime dhe mendime gjithëpërfshirëse, veçanërisht në “14,000” rastet¹³, ku faktet ishin mjaftueshëm të ngjashme për të lejuar kategorizimet e tilla. Vetëm një numër i vogël i rasteve nga kjo kategori kanë mbetur të hapura, meqë përfundimin e këtyre rasteve Paneli e ka caktuar si prioritet.

¹² Për informacione të mëtejshme për reagimin e UNMIK-ut ndaj rekomandimeve dhe të gjeturave të Panelit në rastin *Kusiç*, Lënda e PKDNJ nr. 08/07 shih Raportin vjetor të vitit 2010 §§ 122-124.

¹³ U referohemi mijëra lëndëve të parashtruara kundër UNMIK-ut, KFOR-it, dhe IPVQ-ve, dhe komunave të ndryshme në vitin 2004, për të cilat lëndë është pezulluar procedura pas një shkresë të dërguar nga UNMIK-u gjykatave të ndryshme në Kosovë. Në kohën kur është dërguar shkresa, i referohej “mbi 14,000 lëndëve” të paraqitura. Në fund, shifra ishte afër 17,000 – 18,000 lëndë.

46. Në vitin 2012, Paneli dhe Sekretariati vazhduan të përdorin në mënyrë më gjithëpërfshirëse burime të tjera për mbledhjen e informacioneve që ishin të pamundura për t'u mbledhur nga parashtresat e ankuesve dorëzuar Panelit. Për shembull, Prokuroria publike e qarkut në Prishtinë disa herë i ka siguruar Panelit informacione të paçmueshme që deri tani kanë qenë të paarritshme.
47. Sekretariati gjithashtu u takua me ankues individual si dhe me organizata që kishin lidhje me rastet, siç janë Asociacioni i familjeve të personave të kidnapuar dhe vrapë në Kosovë dhe Metohi, për të mbledhur informacionet relevante kur kërkohet. Për të përshpejtuar procedimin e disa rasteve, Sekretariati vendosi kontakt me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, për të marrë dokumentacione, duke përfshirë edhe dosje të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe aktgjykime të Dhomës së Posaçme të cilat nuk ishin siguruar nga ankuesit. Në fakt, u grumbulluan aq shumë materiale përmes kësaj metode sa që Paneli kishte mundësi të merrte vendime dhe mendime gati për të gjitha lëndët në këtë kategori. Gjithashtu, Paneli kishte korrespondenca të rregullta me Agjencinë Kosovare të Pronës, që Panelit i mundësoi të nxjerrë vendime dhe mendime për një pjesë të madhe të lëndëve të pazgjidhura në këtë kategori.
48. Përveç rasteve të sipërpërmendura, Paneli vazhdoi me procedimin e rasteve, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me çështjet vijuese ligjore:
- Pohimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ), si dhe e drejta për mjet të efektshëm (neni 13 i KEDNJ), lidhur me vendimet e nxjerra nga Drejtoria për çështje banesore pronësore dhe nga Komisioni i tij për ankesa banesore pronësore, dhe Agjencia Kosovare e Pronës dhe Komisioni i saj për ankesa lidhur me pronësinë dhe zotërimin e pronës.
 - Pohimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i KEDNJ), e drejta për respektim të jetës private dhe familjare (neni 8 § 1 i KEDNJ), e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ), si dhe e drejta për mjet të efektshëm (neni 13 i KEDNJ), lidhur me dëbimet e pasuksesshme të uzurpuesve, siç pohohej të paligjshëm të pronave.
 - Pohimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i KEDNJ), e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ), e drejta për mjet të efektshëm (neni 13 i KEDNJ), lidhur me siç pohohej vendimet konfliktuoze për rastet pronësore ndërmjet Drejtorisë për çështje banesore pronësore apo Agjencisë Kosovare të Pronës dhe gjykatave komunale dhe atyre të qarkut.
 - Pohimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i KEDNJ), dhe e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ) si dhe e drejta për mjet të efektshëm (neni 13 i KEDNJ), lidhur me konfiskimin e pronës nga prokurorët publik ndërkombëtarë dhe prokurorët publik të qarkut të Gjilanit.

- Pohimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i KEDNJ) dhe e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ), lidhur me vendimet e nxjerra nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, që kanë të bëjnë me përfitimet e punëtorëve që është dashur t'u paguhen përmes privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore (NSH) si dhe pronësia e NSH-ve.
- Pohimet për shkelje të së drejtës për qasje në shërbimet publike dhe të së drejtës për mjet të efektshëm (neni 2 § 3 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), lidhur me nenin 25 c të KNDCP) lidhur me vendimet e nxjerra nga Komiteti i Përbashkët Ekzekutiv për Siguri (KPES) dhe Gjykata Supreme e Kosovës lidhur me shkarkimin e ankuesit nga pozita komanduese.

7. Praktika gjyqësore e Panelit

3. Viti 2012 shënoi vitin kur Paneli pati mundësinë të arrijë progres të konsiderueshëm në trajtimin e lëndëve të pazgjidhura. Në mbylljen e 95 rasteve nga lista e çështjeve gjyqësore, Paneli nxori vendime dhe mendime me të cilët ankuesve u bëri me dije se është arritur një shkallë e caktuar progresi në përmbylljen e lëndëve, përderisa njëkohësisht zgjeronte praktikën e tij gjyqësore me një sërë praktikash të reja dhe çështje substanciale. Disa vendime dhe mendime të rëndësishme që Paneli i ka marrë në vitin 2012 janë përshkruar detajisht më poshtë.

7.1 Çështjet e pranueshmërisë

Rregulla për periudhën gjashtëmujore

49. Rregulla gjashtëmujore zbatohet për paraqitjen e ankesës por nuk vlen për parashtrimin e kërkesës për rihapje të procedurës. Kërkesa për rihapje të procedurës duhet të parashtrohet brenda një kohe të arsyeshme. Shih PKDNJ, *Balaj dhe të Tjerët*, nr. 04/07, vendim i 11 majit 2012.

Kompetenca lëndore (*Ratione Materiae*)

50. Kur ankuesi nuk ka mundësi legjitime të gëzojë të drejtën e tij pronësore në mënyrë efektive për shkak se situata e tij nuk i përmbush kushtet për të kërkuar një pjesë të fitimit nga privatizimi i ish vendeve të tij të punësimit, nuk kemi të bëjmë me të drejtën reale në pronë dhe ankesa është jashtë kompetencës lëndore të Panelit (*ratione materiae*). Në rastin *Bojkoviç*, ankuesja u ankua se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) e kishte shkelur të drejtën e saj për të marrë një pjesë të fitimit nga privatizimi i dy ndërmarrjeve në pronësi shoqërore për të cilat ajo kishte punuar. Ankuesja nuk kishte të drejtë në marrjen e këtyre fitimeve sepse ajo ishte larguar nga ndërmarrjet para vitit 1999, para se AKM-ja të merrte pushtetin mbi ta. Prandaj, edhe pse ankuesja kishte parashtruar kërkesë pranë AKM-së, Paneli gjeti se ankuesja nuk kishte “mundësi legjitime” për pranimin e kërkesës së saj. Prandaj, ankesa ishte jashtë kompetencës

lëndore të Panelit (*ratione materiae*). Shih PKDNJ, *Bojkoviç*, nr. 40/10, vendim i 16 marsit 2012.

Juridiksioni *Ratione Personae*

51. Paneli konsideron se në disa raste lidhur me ngjarjet që ndodhën pasi UNMIK-u pushoi ushtrimin e pushtetit ekzekutiv për çështje të caktuara, Paneli nuk kishte juridiksion *ratione personae* për akterët të cilët ishin përgjegjës për aktet e dyshuara. Në rastin *Jovanoviç dhe të Tjerët*, Paneli ripohoi qëndrimin tij të mëparshëm duke përkujtuar se më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.
52. Në rastin *Jovanoviç dhe të Tjerët*, ankuesit u ankuan se Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) kishte shkelur të drejtat e tyre në marrjen e një pjese të fitimeve nga privatizimi i kompanisë për të cilën ata kishin punuar. Gjatë shqyrtimit të kompetencës së tij *ratione personae* për trajtimin e ankesës, Paneli theksoi se AKP-ja ishte institucion i themeluar nga autoritetet e Kosovës dhe prandaj ishte jashtë juridiksionit të Panelit. Gjithashtu, Paneli theksoi se ankuesit nuk kishin parashtruar ankesë kundër vendimit të AKP-së në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë e Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme), por edhe po të kishin parashtruar, UNMIK-u nuk e ushtronte më autoritetin mbi gjyqësorin e Kosovës dhe prandaj nuk kishte përgjegjësi për asnjë shkelje të të drejtave të njeriut që pohojë se ishin kryer nga ata. Si të tilla, ankesat ishin jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Shih PKDNJ, *Jovanoviç dhe të Tjerët*, nr. 27/10, vendim i 20 janarit 2012.
53. Gjithashtu, në rastin *Stojanoviç dhe të Tjerët*, Paneli konstatoi se kur ankuesit ishin ankuar në Dhomën e Posaçme por Dhoma e Posaçme akoma nuk kishte marrë vendim, ankesat ishin jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Shih PKDNJ, *Stojanoviç dhe të Tjerë*, nr. 28/10, vendim i 17 shkurtit 2012.

Mos-shterimi i mjeteve juridike

54. Kur lënda e një ankese ka të bëjë me një vonesë të pohuar të kohëzgjatjes së procedurës, ankesa mund të jetë e pranueshme edhe pse nuk janë ndjekur të gjitha mjetet në dispozicion për rishqyrtim. Në rastin *Mladenoviç*, ku ankuesi u ankua se kërkesa e tij drejtuar AKP-së nuk ishte përfunduar më shumë se katër vite pasi e kishte dorëzuar, Paneli konkludoi se argumenti i UNMIK-ut se ankuesi nuk i kishte shterur të gjitha mjetet në dispozicion nuk ishte relevant në këtë rrethanë. Paneli theksoi se fakti që procedura akoma ishte në pritje për shqyrtim nuk mund të kompensojë shkeljen e pohuar të nenit 6 § 1 të KEDNJ që buron nga kohëzgjatja e procedurës. Shih PKDNJ, *Mladenoviç*, nr. 61/10, vendim i 6 prillit 2012.

Rihapja e procedurës

55. Në vitin 2012, në rastin *Balaj dhe të Tjerët*, Paneli ripohoi qëndrimin e tij se ankuesit mund të kërkojnë nga Paneli të rihapë procedurat të cilat fillimisht ishin të pranueshme *ratione temporis* kur ishin paraqitur por që përkohësisht ishin shpallur të papranueshme nga Paneli derisa ankuesi e kishte përfunduar procesin e KB-së për ankesa nga palët e treta, ashtu siç kërkohet me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1. Kjo procedurë e veçantë, të cilës tash e tutje do t'i referohemi si “përrjashtimi Balaj” u kërkuar nga Paneli për të kompensuar rezultatin e papranueshëm të zbatimit strikt të nenit 5 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1.
56. Në rastin *Balaj dhe të Tjerët*, ankuesit fillimisht parashtruan atë që Paneli e konsideroi ankesë të pranueshme, por më vonë kompetencat e Panelit u ndryshuan me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, që shtoi edhe një pengesë tjetër duke kërkuar që ankuesi të sterrojnë mjetet që i ofrohen nga procesi i KB-së për ankesa nga palët e treta para se t’ia drejtojë ankesën Panelit. Në një vendim të dytë me të cilin tani ankesa konstatohet se është e papranueshme, Paneli theksoi, “nëse nga ankuesit kërkohet të riparashtrorjnë ankesë pas përfundimit të procesit të KB-së për ankesa nga palët e treta ata padyshim do të jenë në kundërshtim me afatin e 31 marsit 2010 për parashtrimin e ankesave të reja. Kërkesa për të kaluar nëpër procesin e KB-së për ankesa nga palët e treta në këtë rast, në të vërtetë, e shuan ankesën pa ua dhënë mundësinë ankuesve ta parashtrorjnë sërish pranë Panelit, përkundër faktit se, siç konstatoi Paneli më 6 qershor 2008, ankesa ishte e pranueshme sipas kornizës rregullative e cila ishte në fuqi në kohën e parashtrimit të ankesës. Rezultatet e tilla do të ofendonin nocionet bazike të drejtësisë. Në vitin 2012, Paneli konkludoi, mbi kundërshtimin e UNMIK-ut, se meqë procesi i KB-së për ankesa nga palët e treta kishte përfunduar, ankuesit mund të kërkonin nga Paneli të rihapë procedurën e iniciuar në vitin 2007, pa e konsideruar afatin e fundit të 31 marsit 2010 si pengesë për vazhdimin e shqyrtimit të ankesës së tyre. Shih PKDNJ, *Balaj dhe të Tjerët*, nr. 04/07, vendim i 11 majit 2012.
57. Në rastet *Linda, LLC* dhe *NTP Bujari (AS Petrol)*, Paneli vendosi se rastet që ishin nën kompetencën e Bordit të UNMIK-ut për rishikimin e ankesave/kërkesave vendore kishin të drejtë në zbatimin e “përrjashtimit Balaj” (shih § 57 lart), meqë ankesat e tilla mund të apelohej pranë procesit të KB-së për ankesa nga palët e treta dhe mbulohen me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut 2009/1. Në të dyja rastet, ankuesit kishin të drejtë të parashtrorjnë ankesa në Bordin e UNMIK-ut për shqyrtimin e ankesave vendore. Edhe pse Paneli gjeti se ato janë të papranueshme në këtë fazë, Paneli vendosi që ankesave t’u lejojë mbrojtjen speciale që mundësohet me “përrjashtimin Balaj”. Shih PKDNJ, *Linda, LLC*, nr. 45/08, vendim i 22 gushtit 2012 dhe *NTP Bujari (AS Petrol)*, nr. 311/09, vendim i 6 dhjetorit 2012.

Statusi i viktimës dhe realizueshmëria e ankesës pas marrjes së kompensimit dhe heqja dorë nga të drejtat gjatë procesit të ankesave nga palët e treta

58. Një çështje tjetër e re e vendosur në rastin *Balaj dhe të Tjerët* kishte të bënte me vazhdimin e të drejtës së ankuesit që të konsiderohet viktimë nga Paneli, dhe të jetë nën kompetencën e Panelit ashtu siç theksohet në nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. Paneli theksoi se edhe pse ankuesit ishin kompensuar nga procesi i KB-së për ankesa nga palët e treta me ankesën në të cilën pohoheshin faktet e njëjta, roli i procesit të KB-së për ankesa nga palët e treta ishte ndryshe nga juridiksioni i Panelit. Për më tepër, Paneli sqaroi se kompensimi që ju kishte paguar ankuesve nuk ishte i bazuar në asnjë formë të pranimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të ankuesve. Më saktë, kjo përbënte një pagesë *ex gratia*. “Detyrimi procedural sipas nenit 2 dhe 3 të KEDNJ nuk mund të konsiderohet i përmbushur me pagesën e shumave të parave, si kompensim për dëmet monetare që i kanë pësuar viktimat dhe familjet e tyre” Prandaj, Paneli konkludoi se ankuesit vazhdojnë të kenë statusin e viktimës meqë ankesat e tyre mbesin të realizueshme dhe të pranueshme. Shih PKDNJ, *Balaj dhe të Tjerët*, nr. 04/07, vendim i 11 majit 2012.
59. Në rastin *Balaj*, Paneli po ashtu vendosi se ankuesit nuk kishin hequr dorë nga të drejtat e tyre për të marrë mendim për bazueshmërinë e ankesave nga Paneli kur ata nënshkruan heqjen dorë në negociatat e tyre gjatë procesit të ankesave nga palët e treta. Në aktin e heqjes dorë thuhej “Unë e kuptoj se kjo ofertë zgjidh plotësisht dhe përfundimisht të gjitha ankesat/kërkesat e çdo natyre dhe lloji çfarëdo qofshin ata që rezultojnë nga sa u tha më lart (vdekje apo lëndime).” UNMIK-u konsideroi se kjo përbënte heqje dorë nga të gjitha kërkesat/ankesat e çdo lloji, duke përfshirë edhe të drejtat e ankuesve pranë Panelit. Paneli nuk u pajtua më këtë dhe arsyetimin e tij e bazoi në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila konstatoi se nga të drejtat e rezervuara me nenin 2 dhe 3 të KEDNJ nuk lejohet të hiqet dorë në asnjë rrethanë. Shih PKDNJ, *Balaj dhe të Tjerët*, nr. 04/07, vendim i 11 majit 2012.

Dokumentet që duhet të merren parasysh

60. Kur Paneli kërkon dokumentacion plotësues nga një ankues, Paneli është i lirë të interpretojë dokumentacionin nga pikëpamja e tillë saqë fakteve të prezantuara aty u jepet një karakteristikë tjetër ligjore nga ajo që Panelit i është paraqitur fillimisht në ankesë. Shih PKDNJ *Laliç*, nr. 31/08, vendim i 9 qershorit 2012.

7.2 Çështjet përmbajtësore

7.2.1. E drejta për jetë – neni 2 i KEDNJ

61. Pasi Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ia komunikoi emrin e viktimës UNMIK-ut përmes shkresave të tij të datës 12 tetor 2001 ose 11 shkurt 2002, autoritetet e UNMIK-ut kishin për obligim të zbatonin hetim të efektshëm për zhdukjen e viktimës në pajtim me nenin 2 të KEDNJ. Shih PKDNJ *Tomiç*, nr. 160/09, vendim i 5 prillit 2012.
62. Paneli nuk e ndan obligimin për zbatimin e një hetimi përmes të cilit do të përcaktohej fati dhe vendndodhja e personit të zhdukur nga obligimi për zbatimin e një hetimi i cili do të përcaktonte nëse ka pasur një zhdukje të paligjshme dhe hetimi të shpie në

identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës. Paneli vazhdon punën mbi bazën e vazhdimit të vetëm një obligimi. Mirëpo, natyrisht, fakti se mbetjet mortore të viktimës janë gjetur dhe më vonë janë identifikuar është një element i rëndësishëm që duhet marrë parasysh në vlerësimin e gjithëmbarshtëm të përmbushjes së obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ. Shih PKDNJ *Simoviç*, nr. 246/09, vendim i 6 prillit 2012.

63. Kur nuk ka indikacion se autoritetet e UNMIK-ut u informuan apo në ndonjë mënyrë tjetër mësuan për vdekjen e viktimës, UNMIK-u nuk kishte obligim të zbatojë hetim të efektshëm për vdekjen e tillë sipas nenit 2 të KEDNJ. Shih *Majmareviç*, nr. 324/09, vendim i 10 majit 2012.
64. Detyrimi i UNMIK-ut për të kryer hetime sipas nenit 2 të KEDNJ shtrihet mbi vdekjen e dhunshme në rrethana të dyshimta për të gjitha rastet e vdekjeve përveç atyre nga shkaqe natyrore, qofshin kryerësit persona privatë ose agjentë shtetërorë apo persona të panjohur. Shih PKDNJ, *R.A.*, nr. 41/09, vendim i 17 gushtit 2012.
65. Kur nga informacionet e paraqitura nga ankuesi asgjë nuk tregon se ai ka parashtruar ndonjëherë ankesë pranë autoriteteve relevante të UNMIK-ut lidhur me dyshimet e tij për rrethanat e vdekjes, Paneli konsideroi se nën këto rrethana UNMIK-u nuk e kishte obligimin të kryej hetime të efektshme për vdekjen sipas nenit 2 të KEDNJ. Shih *Baraç*, nr. 149/09, vendim i 1 tetorit 2012.
66. Në rastin *S.C.* Paneli duhej të vendoste nëse UNMIK-u kishte zbatuar hetim të efektshëm ashtu siç kërkohet me nenin 2 të KEDNJ. Në këtë rast, ankuesja pohoi se dy anëtarë të familjes ishin rrëmbyer dhe vrarë nga pjesëtarë të UÇK-së në vitin 1999; vrasësit e tyre asnjëherë nuk u identifikuan ose sollën para drejtësisë. UNMIK-u argumentoi se ishte kryer një hetim i efektshëm lidhur me rrëmbimin dhe vrasjen e viktimave; mirëpo, për shkak të informacioneve minimale dhe pistave të hetimit në dispozicion, nuk mund të arriheshin rezultate konkrete. Pas rishikimit të dosjes, Paneli nuk u pajtua me këtë. “Kur flasim për periudhën nën kompetencën e tij, duke filluar nga 23 prilli 2005, Paneli thekson se hapat bazike hetimore, siç janë marrja në pyetje e ankueses dhe dëshmitarëve të rrëmbimit akoma nuk ishin bërë. Përveç kësaj, Paneli konsideron se, meqë përgjegjësit për krimin nuk ishin gjetur, UNMIK-u ishte i obliguar të përdorte mjetet që i kishte në dispozicion për të rishikuar rregullisht progresin e hetimeve për të siguruar se nuk ishin zbardhur fakte të reja, si dhe të informonte të afërmit e viktimave lidhur me pistat e reja të mundshme të hetimit. Paneli thekson se rasti, që në ndërkohë ishte klasifikuar si “joaktive” në pritje të informacioneve të reja, ishte rishikuar në tetor përkatësisht nëntor 2007. Mirëpo, Paneli konsideron se të dy rishikimet ishin larg nga të qenurit adekuat. Në fakt, hetuesit rishikues nuk identifikuan zbrazëtirat evidente në hetimin e kryer deri tani, dhe gabimisht raportuan se viktimat akoma ishin të zhdukur.”
67. Paneli konsideroi se nuk ishin ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm nga UNMIK-u për identifikimin e kryerësve dhe sjelljen e tyre para drejtësisë. Në këtë kuptim Paneli

konsideroi se hetimi nuk ishte adekuat dhe nuk i përmbushi kushtet e të qenurit i përpiktë, i shpejtë dhe efektiv, siç kërkohet me nenin 2.

68. Paneli duhej të vendoste nëse UNMIK-u kishte përmbushur kushtin që hetimi penal të jetë publik, të përcaktuar me nenin 2 të KEDNJ. Paneli konstatoi se UNMIK-u nuk e kishte përmbushur këtë kusht. “Paneli përkujton se neni 2 gjithashtu kërkon që në hetim të përfshihet i afërmi i viktimës deri në shkallën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tij legjitime. Paneli thekson se, sipas informacioneve të paraqitura në Panel, familja e ankueses (djali i saj) ishte kontaktuar vetëm një herë nga UNMIK-u, lidhur me dorëzimin e trupave të viktimave në vitin 2003... asnjëherë nuk ishte marrë deklaratë nga ankuesja dhe ankuesja nuk kishte marrë informacione lidhur me gjendjen e hetimeve, duke përfshirë edhe informacionin që lënda ishte klasifikuar si ‘joaktive’ në vitin 2005. Prandaj, Paneli konsideron se familja e ankueses nuk kishte qasje në hetimet ashtu siç kërkohet me nenin 2.” Duke pasur parasysh këto të meta dhe mungesa, Paneli konkludoi se UNMIK-u kishte dështuar në zbatimin e një hetimi të efektshëm për rrëmbimin dhe vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të ankueses, duke shkelur nenin 2 të KEDNJ. Shih *S.C.*, nr. 02/09, mendim i 6 dhjetorit 2012.

7.2.2. E drejta për liri – neni 5 i KEDNJ

69. Mu sikurse kur UNMIK-u kishte detyrimin të hetojë shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut sipas nenit 2 të KEDNJ, UNMIK-u kishte detyrim të ngjashëm të hetojë rrethanat e rrëmbimeve dhe ndalimeve, që pretendohet se ishin bërë kundër ankuesve duke shkelur nenin 5 të KEDNJ. Prandaj, Paneli konsideroi në mënyrë specifike se dështimi i pohuar i UNMIK-ut në zbatimin e hetimeve efektive për rrethanat e rrëmbimit dhe ndalimit të paligjshëm të civilëve gjatë operacioneve të UÇK-së paraqet shkelje të vazhdueshme të të drejtave të viktimave, të garantuar me nenin 5 të KEDNJ, dhe prandaj ankesa ishte e pranueshme. Shih PKDNJ, *Kostiç dhe të Tjerët*, nr. 111/09 et al, vendim i 17 gushtit 2012.

7.2.3. E drejta për respektim të jetës private dhe familjare – neni 8 i KEDNJ

70. Zhdukja e mbetjeve mortore të një personi, duke mohuar në këtë mënyrë varrimin në varrezat familjare dhe shënimin e varrit mund të jenë dëshmi të shkeljes së nenit 8 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Joviçiç*, nr. 233/09, vendim i 17 marsit 2012.

7.2.4. E drejta për gjykim të drejtë – neni 6 § 1 i KEDNJ

E drejta për qasje në gjykatë

71. Ankuesi konsiderohet nën “akuzë” për qëllimet e nenit 6 § 1 të KEDNJ, d.m.th. e drejta e ankuesve që ankesat e tyre të vendosen nga gjykatat, nga momenti kur atyre u dorëzohet urdhri për bastisje dhe konfiskim. Fakti se kallëzimi penal kundër ankuesit përfundimisht hidhet poshtë nuk i heq mbrojtjet që i ofron neni 6 § 1 i KEDNJ. Shih PKDNJ, *Morina*, nr. 36/08, mendim i 10 majit 2012.

Drejtësia e procedurës

72. Edhe pse si rregull e përgjithshme e drejta për dëgjim publik nënkupton të drejtën për dëgjim verbal, pasi ishte në interesin publik që vendimi për ankesën e ankuesit të merret përmes procesit të shqyrtimit të ankesës në numër të madh nga Komisioni i Ankesave për Çështje Banesore Pronësore (KAÇBP) pa dëgjim verbal, e drejta e tij për gjykim të drejtë e garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ nuk u shkel. Shih PKDNJ *Dekiç dhe Morina*, nr. 36/09 dhe 37/09, vendim i 21 gushtit 2012.

Kohëzgjatja e procedurës

73. Në rastin *Mihajloviç*, Paneli vendosi se Drejtoria për Çështje Banesore Pronësore (DÇBP) e kishte ekzekutuar vendimin e KAÇBP duke urdhëruar riposedim të pronës së ankuesit brenda një periudhe kohore të arsyeshme, dhe kështu ishte përmbushur kushti i nenit 6 § 1 të KEDNJ lidhur me kohëzgjatjen e procedurës. Në mënyrë specifike, Paneli gjeti se ankuesi nuk i kishte siguruar Panelit dëshmi se prona nuk ishte plumbuar në mënyrë adekuate nga DÇBP pas dëbimit. Çdo person i cili më vonë ka hyrë në pronën e plumbuar është dashur të largohet nga autoritetet për zbatimin e ligjit dhe jo nga DÇBP, meqë DÇBP i kishte kryer detyrat e veta sipas ligjit. Në këtë aspekt, Paneli thekson se nuk ka pasur indikacion në ankesën ose në parashtrirat e mëvonshme se ankuesi i kishte kontaktuar autoritetet për zbatimin e ligjit, për të raportuar se prona e tij ishte uzurpuar ilegalisht. Kështu që, përkundër faktit se i tërë procesi nga parashtrimi i ankesës nga ana e ankuesit në KAÇBP për riposedim të pronës së tij deri në posedimin efektiv të saj kaluan gati dhjetë muaj, ankuesi ishte pajtuar se DÇBP/AKP-ja ishin të liruar nga çdo obligim tjetër lidhur me pronën e tij pasi e kishin bërë dëbimin dhe e kishin plumbuar pronën. Paneli me keqardhje theksoi se përderisa nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ, ankuesi nuk kishte mundur të riposedojë pronën e tij. Paneli theksoi se “kjo situatë faktike nuk është e pazakonshme dhe potencon se sistemi i krijuar për fitimin e riposedimit të pronës për personat e zhvendosur nga Kosova ka qenë i vështirë dhe plot me paqartësi.” Shih PKDNJ, *Mihajloviç* nr 15/08, mendim i 22 gushtit 2012.
74. Mirëpo, në rastin *Morina*, Paneli gjeti se mosaktiviteti i prokurorëve publik ndërkombëtarë dhe prokurorëve publik të qarkut në Gjilan dhe Prishtinë, UNMIK-u kishte shkelur të drejtën e ankuesit për dëgjim të drejtë dhe publik brenda një periudhe kohore të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ. Në rastin *Morina*, ankuesit ju konfiskua prona nga UNMIK-u gjatë një hetimi penal që filloi në vitin 2002 dhe pushoi në vitin 2008; prona e tij asnjëherë nuk ju kishte kthyer. Paneli gjeti se gjatë kohëzgjatjes së kompetencave të tij për ankesën, nga prilli 2005 deri më 2008, kishin kaluar më shumë se tri vite gjatë së cilës ankuesi nuk kishte pasur mundësi të kontestojë konfiskimin e pronës së tij. Paneli konkludoi se kjo kohëzgjatje ishte e tepruar dhe nuk përmbushi kushtin e “kohës së arsyeshme” të nenit 6 § 1 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Morina*, nr. 36/08, mendim i 10 majit 2012.

7.2.5. E drejta për mbrojtje të pronës – neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ dhe e drejta për mjet të efektshëm – neni 13 i KEDNJ

75. Në rastin *Morina*, ankuesi argumentoi se pas pushimit të akuzave kundër tij, autoritetet e UNMIK-ut nuk ja kthyen mallrat që ata i kishin konfiskuar gjatë hetimit, ashtu siç përcaktohet me ligjin, që ishte shkelje e të drejtës së tij në pronë, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Ankuesi kishte drejtuar një dyqan duke shitur municion për gjueti. Prona e tij ishte konfiskuar pasi kishte filluar një hetim penal kundër tij; kjo pronë asnjëherë nuk ju kishte kthyer, edhe pasi kishte përfunduar hetimi në vitin 2008. Pas rishikimit të dosjes, Paneli konkludoi se nuk kishte bazë sipas ligjit në fuqi për moskthimin e mallrave të konfiskuara përkohësisht ankuesit pasi akuzat kundër tij ishin hedhur poshtë. Prandaj, UNMIK-u e kishte shkelur të drejtën e tij për pronë të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.
76. Paneli duhej të vendoste nëse e drejta e ankuesit për mjet të efektshëm të garantuar me nenin 13 të KEDNJ ishte shkelur po ashtu. Ankuesi argumentoi se gjatë dhe pas përfundimit të hetimeve kundër tij, ai nuk kishte mjete efektive për të ndaluar konfiskimin. Paneli theksoi se ankuesi nuk kishte mekanizëm në dispozicion që atij do t'i mundësonte të kërkonte kompensim për aktet e padrejta që pohohej se ishin kryer nga autoritetet gjyqësore. Prandaj, Paneli konkludoi se kishte pasur shkelje të nenit 13 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Morina*, nr. 36/08, mendim i 10 majit 2012.
77. Kur sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr. 1244 të datës 10 qershor 1999 u vendos prania civile ndërkombëtare për të siguruar një administrim të përkohshëm, “autoriteti nacional” në kuptim të nenit 13 të KEDNJ dihet se është autoritet i themeluar nga administrata ndërkombëtare, apo së paku është nën kontrollin e saj. Meqë UNMIK-u themeloi KAÇBP, KAÇBP konsiderohet të jetë “autoritet nacional”, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ. Shih PKDNJ, *Dekaç dhe Morina*, nr. 36/09 dhe 37/09, vendim i 21 gushtit 2012.

7.2.6. E drejta për qasje në shërbimet publike dhe e drejta për mjet të efektshëm – neni 2 § 3 i KNDCP, në lidhje me nenin 25(c) të KNDCP

78. Në rastin *Thaçi*, Paneli duhej të vendoste nëse ishin shkelur të drejtat e ankuesit kur ai nuk kishte pasur mundësi të kundërshtojë në mënyrë adekuate uljen e tij në pozitë, suspendimin dhe largimin nga pozita e tij. Ankuesi ishte ish komandant në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), i cili ishte ulur në pozitë dhe më vonë ishte suspenduar në vitin 2001 për mosveprim në përputhje me ligjin përkatës, veçanërisht për dhënien e deklaratave të paautorizuara në media për TMK-në dhe për mungesë të paautorizuar nga puna. Në një datë të papërcaktuar në vitin 2001, ai ishte shkarkuar nga Komiteti i Përbashkët Ekzekutiv për Siguri (KPES), që në atë kohë ishte organi më i lartë për koordinimin e çështjeve të sigurisë në mes të UNMIK-ut dhe KFOR-it. Sipas ankuesit, më 15 korrik 2005, ai parashtrroi ankesë kundër shkarkimit të tij përmes zinxhirit të tij komandues por ai nuk morri përgjigje deri në mars të vitit 2006, kur ankesa e tij u hodh poshtë për arsye procedurale. Ai parashtrroi ankesë ndaj kësaj përgjigjeje në Gjykatën Supreme të Kosovës, por edhe ajo e refuzoi ankesën e tij, duke pohuar se nuk kishte kompetenca për këtë çështje meqë KPES dhe TMK gëzonin imunitet nga juridiksioni i Gjykatës Supreme.

79. Pasi Paneli mësoi se ndaj ankuesit ishin shqiptuar sanksione disiplinore duke mos parë ndonjë indikacion të qartë se komenteve të tij për akuzën ju kishte kushtuar vëmendje e duhur, Paneli shqyrtoi praktikën përkatëse gjyqësore të Komitetit të KB-së për të Drejtat e Njeriut dhe gjeti se procedura disiplinore, që çoi në shkarkimin e ankuesit nga TMK-ja, nuk i respektoi kushtet e drejtësisë bazike procedurale. Prandaj, procedura nuk respektoi të drejtën fundamentale të ankuesit për qasje në shërbimet publike dhe prandaj kjo ishte shkelje e nenit 2 § 3 të KNDCP, lidhur me nenin 25(c) të KNDCP. Paneli gjithashtu konstatoi se edhe pse e drejta për të parashtruar ankesë kundër shkarkimit në aspektin teorik ishte e hapur, dhe ankuesi e kishte shfrytëzuar këtë të drejtë, ankesa nuk çoi në shqyrtim të ri të akuzave kundër ankuesit. Paneli konsideroi se mosndërmarrja e veprimeve për trajtimin e ankesës përbënte dështim në respektimin e të drejtës fundamentale të ankuesit për mjet të efektshëm për shkeljen e të drejtës së tij për të mos u shkarkuar në mënyrë arbitrare nga shërbimi publik.
80. Sa i përket ankesës së ankuesit të parashtruar pranë Gjykatës Supreme, UNMIK-u kishte argumentuar se ankuesi gjatë tërë kohës kishte pasur qasje në mjetet juridike të siguruar në fazat e ndryshme të procedurës. Me paraqitjen e ankesës pranë Gjykatës Supreme, ai në fakt shfrytëzoi mjetet administrative dhe juridike, dhe atij nuk ju kishte mohuar qasja në këto mjete. Paneli u pajtua me UNMIK-un për këtë pikë, duke vendosur se duke i dhënë efekt imunitetit të KPES dhe TMK nga juridiksioni i gjykatave të Kosovës, Gjykata Supreme me veprimin e saj nuk shkeli të drejtën e ankuesit për mjet të efektshëm. Paneli theksoi se “imuniteti i dhënë UNMIK-ut dhe KFOR-it ka të bëjë me veprimet apo mosveprimet që i atribuohen KPES dhe TMK-së. Këto janë dy organe që drejtpërsëdrejti u morën me çështjet e sigurisë për të cilat u themeluan UNMIK-u dhe KFOR-i. Prandaj, nuk ka hapësirë për ndonjë shmangie të mundshme nga parimet që lidhen me imunitetin e Kombeve të Bashkuara në çështjet e sigurisë ...” Shih PKDNJ, *Thaçi*, nr. 13/08, mendim i 12 shtatorit 2012.

8. Rekomandimet e Panelit

81. Në vitin 2012, Paneli miratoi disa mendime mbi bazueshmërinë ku konstatoi shkelje të të drejtave të njeriut për të cilat përgjegjës ishte UNMIK-u. Këtë vit, sikurse në vitin 2011, për Panelin ishte disi problematike se çfarë rekomandimesh duhej të bënte në një situatë ku UNMIK-u nuk është më në gjendje të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimet që merren në Kosovë. Siç u tha më herët, UNMIK-u nuk mund të ndryshojë legjislacionin sipas nevojës (ose, sido që të jetë, edhe po të ndryshonte legjislacionin përkatës, nuk mund më të sigurojë zbatimin e tij), as nuk mund t’i urdhërojë autoritetet e Kosovës të korrigjojnë të metat tjera të identifikuar nga Paneli. Kjo situatë kërkonte që Paneli të jetë i vetëdijshëm për kufizimet e tilla derisa i bënte rekomandimet që do të kishin ndikim përfitues në situatën e të drejtave të njeriut të ankuesve të ndikuar nga kjo gjendje.
82. Në disa raste, Paneli rekomandoi kompensim monetar dhe jomonetar për shkeljen e bërë (shih PKDNJ, *Morina*, nr. 36/08, mendim i 10 majit 2012). Në raste të tjera, Paneli do të kishte rekomanduar veprime të caktuara konkrete që duhej të ndërmernte UNMIK-

u për të rregulluar situatën, po të mos ishte fakti se UNMIK-u nuk ishte më në gjendje të ushtrojë mandatin e tij sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr. 1244, pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë së autoriteteve të Kosovës dhe zhvillimeve të mëpastajme në terren. Duke e pranuar faktin se UNMIK-u nuk mund më të ndërmerre hapat e nevojshëm për korrigjimin e një situatë, Paneli ka rekomanduar që UNMIK-u të ndajë mendimet me akterët relevantë për të nxitur ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme. Paneli e përdori këtë formulë në rastin *Lajović dhe të Tjerët*, duke rekomanduar që UNMIK-u “të nxisë autoritetet e Kosovës të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm për të siguruar që rastet e ankuesve do të vendosen pa vonesë” Shih PKDNJ, *Lajović dhe të Tjerët*, nr. 09/08 dhe të tjerë, mendim i 9 qershorit 2012.

83. Në një situatë tjetër, në rastin *S.C.* (të cilës ju referuam në §§ 68-70 lart), Paneli gjeti se UNMIK-u kishte bërë shkelje të nenit 2 të KEDNJ, veçanërisht me dështimin e kryerjes së një hetimi adekuat dhe efektiv për rrëmbimin dhe vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të ankuseses. Ky ishte mendimi i parë ku Paneli e konstatoi këtë shkelje të rëndë. Në këtë rast, Paneli shqyrtoi reparacionet nga një këndvështrim më i gjerë, dhe rekomandoi që UNMIK-u të merr garanci se hetimet do të vazhdojnë në pajtim me kushtet e një hetimi efektiv të paraparë në nenin 2, që rrethanat e zhdukjes dhe vrasjes së viktimave të zbardhen dhe kryerësit të sillen para drejtësisë; që ankuesja dhe/ose i afërmi të informohen për procedurën e tillë dhe dokumentacioni përkatës t’u tregohet atyre sipas nevojës. Përveç kësaj, Paneli rekomandoi që UNMIK-u të pranojë publikisht, brenda një periudhe kohore të arsyeshme, përgjegjësinë për dështimin e kryerjes së një hetimi adekuat për zhdukjen dhe vrasjen e viktimave, dhe ankuseses dhe familjes së saj t’u kërkojë falje publike lidhur me këtë. Paneli gjithashtu rekomandoi që UNMIK-u t’i paguaj kompensimin adekuat ankuseses për dëmin moral që ajo ka pësuar për shkak të dështimit të UNMIK-ut në zbatimin e një hetimi efektiv.
84. Paneli po ashtu rekomandoi që UNMIK-u të ndërmerr hapat e duhur, përmes subjekteve të tjera të KB-së që veprojnë në Kosovë, organeve vendore dhe organizatave joqeveritare, për realizimin e një programi të plotë dhe gjithëpërfshirës për reparacionet, duke përfshirë restitucionin, kompensimin, rehabilitimin, shlyerjen dhe garancionet për mospërsëritje, për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të të gjitha komuniteteve, që kanë ndodhur gjatë dhe pas konfliktit të Kosovës. Përfundimisht, Paneli rekomandoi që UNMIK-u të ndërmerr hapat e duhur pranë organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të KB-së, për alokimin e resurseve adekuate njerëzore dhe financiare për të siguruar mbrojtjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në të gjitha kohërat nga Kombet e Bashkuara, duke përfshirë edhe kohën kur kryhen funksione administrative dhe ekzekutive mbi një territor, dhe të sigurojnë monitorim efektiv dhe të pavarur. Për herë të parë, Paneli bëri rekomandime që nxitën UNMIK-un të kërkojë përgjigje sistematike për shkeljen e të drejtave të njeriut. Paneli shpreson në një reagim të duhur nga UNMIK-u për këtë mendim.
85. Në çdo ankesë deri më sot ku Paneli ka konstatuar shkelje, Paneli ka rekomanduar që UNMIK-u të ndërmerr masa të menjëhershme dhe efektive për implementimin e

rekomandimeve të tij dhe informimin e ankuesit dhe Panelit për zhvillimet e mëtejshme të rastit. Mirëpo, mungesa e informacioneve nga ana e UNMIK-ut për implementimin e rekomandimeve të Panelit është bërë gjithnjë e më brengosëse.

9. Vazhdimi i mosreagimit publik të UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit

86. Paneli thekson se neni 17.3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 parasheh që PSSP-ja të ketë autoritetin ekskluziv dhe diskrecionin për të vendosur nëse do të ndërmarrë veprime për të gjeturat e Panelit, kurse neni 17.4 parasheh që vendimet e PSSP-së të “shpallen menjëherë në anglisht, shqip dhe serbisht, në mënyrën e cila siguron shpërndarje dhe qasje të gjerë.” Që nga viti 2010, UNMIK-u ka publikuar 23 komunikata për shtyp si përgjigje në 92 mendimet e miratuara nga Paneli. Kjo nënkuptonte se UNMIK-u publikoi vetëm 6 reagime publike për 66 mendimet që Paneli i nxori në vitin 2011 dhe 2012, ku Paneli konstatoi shkelje të të drejtave të njeriut për të cilat ngarkohet UNMIK-u. Në Raportin e tij vjetor të vitit 2011, Paneli shprehu zëshëm shqetësimin e tij për mosreagimin publik të UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit dhe në këtë Raport vjetor Paneli e ripërsërit këtë shqetësim. Mirëpo, reagimi i UNMIK-ut me publikimin e vetëm 23 komunikatave për shtyp dhe vetëm 6 në dy vitet e fundit, duket se tregon ngurrimin e tij për të vepruar në përputhje me Rregulloren.
87. Paneli nuk ka zgjidhje tjetër përveç se të kërkojë nga PSSP-ja të ripërsërisë obligimet e UNMIK-ut ndaj ankuesve dhe opinionit të përgjithshëm, dhe të nxjerrë dhe publikojë reagimet e tij ndaj të gjeturave dhe rekomandimeve të Panelit. Siç ka thënë Paneli në raportin e tij vjetor të vitit 2011, pa një reagim të tillë tërësia e procesit e paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 nuk përfundohet. Gjithashtu, përveç se është i papërfunduar, ky proces bëhet paksa i errët dhe teorik. Në të kundërtën, nëse përfundohet i tërë detyrimi gjyqësor, ku Paneli rishqyrton të gjitha pohimet e shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera nga UNMIK-u, nxjerr mendimet publike për të gjeturat dhe rekomandimet e tij, të pasuar me një reagim publik nga UNMIK-u, ky proces do të siguronte ca transparencë dhe përgjegjshmëri për veprimet e UNMIK-ut. Kjo mund edhe të vendosë një standard për misionet e ardhshme të KB-së. Nëse UNMIK-u pranon se bart përgjegjësi dhe e konsideron të duhur të shfrytëzojë kompetencat e tij të rezervuara të kufizuara për të bërë përpjekje që të kompensojë këto shkelje, këto përfundime duhet të bëhen të njohura. Çkado që UNMIK-u beson, Paneli kërkon nga PSSP-ja të merret me ankuesit dhe me opinionin e përgjithshëm publik.
88. Vlen të theksohet se në katër rastet kur PSSP-ja ju përgjigj rekomandimeve të Panelit në vitin 2012, përgjigjet përfshinin gjuhën e njëjtë standarde që ai përdori para tri vitesh në përgjigjen e tij ndaj rastit *Kusiç*, të cekur në § 43 lart.¹⁴ Për shembull, në rastin *Felegi*, ku Paneli kishte rekomanduar kompensim për vonesën e paarsyeshme të procedurës gjyqësore duke shkelur nenin 6 të KEDNJ, në nëntor të vitit 2012, PSSP-ja tha:

¹⁴ Për informacione të mëtejme për këtë përgjigje të UNMIK-ut, shih Raportin vjetor të Panelit të vitit 2010, § 122 *et seq.*, që gjindet në <http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Pages/Annual-Report.aspx>.

“Lidhur me rekomandimin e Panelit për t’u dhënë kompensimin adekuat ankuesve, Paneli është në dijeni se udhëzimet aktuale të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për kompensim nuk e lejojnë Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe misionet e saj të paguajnë kompensim përveç për dëmet materiale ose lëndimet fizike. Duke u bazuar në këtë, UNMIK-u nuk është në pozicion të paguaj kompensim për shkeljet e të drejtave të njeriut që mund të kenë ndodhur në këto raste. UNMIK-u do të vazhdojë të tërheqë vëmendjen e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për nevojën e rishikimit të rregullave aktuale për kompensim, të cilat përjashtojnë pagesën e kompensimit për dëmet jomonetare.”

89. Paneli nuk është i njoftuar për faktin se UNMIK-u ka kërkuar rishikim të rregullave të KB-së për kompensim, për të korrigjuar këtë të metë në skemën e KB-së për kompensim. Paneli përsërit pritjet e tij se UNMIK-u do ta ngrit këtë çështje të rëndësishme në KB me energjinë e duhur në vitin që po vjen.

10. Aneksat:

Aneksi A: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/ mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, më 23 mars 2006

Aneksi B: Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, e datës 17 tetor 2009

Aneksi C: Të dhënat statistikore të PKDNJ

Aneksi D: Vendimet dhe mendimet e PKDNJ të nxjerra në vitin 2012

Aneksi E: Ankesat e PKDNJ të pranuar sipas vitit

Aneksi F: Lëndët e mbyllura të PKDNJ (Të papranueshme, ose mendim mbi bazueshmërinë) sipas vitit

Aneksi G: Shkurtesat dhe akronimet

Aneksi A:

UNITED NATIONS
**United Nations Interim
 Administration Mission**
 in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
**Mission d'Administration
 Intérimaire des Nations Unies au
 Kosovo**

UNMIK/REG/2006/12

23 mars 2006

RREGULLORE NR. 2006/12

MBI THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLDHËNËS PËR TË DREJTAT E

NJERIUT

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke pasur parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të themelimit të Panelit këshillëdhënës për të drejtat e njeriut, si organ i përkohshëm gjatë mandatit të UNMIK-ut, për shqyrtimin e shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut nga ana e UNMIK-ut,

Me anë të kësaj shpall Rregulloren në vijim:

KAPITULLI I: Themelimi dhe kompetencat e Panelit këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 1

Themelimi i Panelit këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut

1.1 Me këtë themelohet Paneli këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut (Paneli këshillëdhënës)

1.2 Paneli këshillëdhënës shqyrton ankesat e çdo personi apo grupit të personave të cilët pohojnë se janë viktime të shkeljes së të drejtave të njeriut nga UNMIK-u sikur që është dhënë në njërën apo në më shumë instrumentet vijuese:

- (a) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e datës 10 dhjetor 1948;
- b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1950 bashkë me Protokollet e saj;
- (c) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike e datës 16 dhjetor 1966 bashkë me Protokollet e saj;
- (d) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e datës 16 dhjetor 1966;
- (e) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor e datës 21 dhjetor 1965;
- (f) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave e datës 17 dhjetor 1979;
- (g) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese e datës 17 dhjetor 1984 dhe
- (h) Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve e datës 20 dhjetor 1989.

1.3 Pas përfundimit të shqyrtimit të një ankese, Paneli këshillëdhënës ia dërgon konkluzionet e veta Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Konkluzionet e Panelit këshillëdhënës, të cilat mund të përfshijnë rekomandime janë të natyrës këshillëdhënëse.

Neni 2

Kompetencat e përkohshme dhe territoriale

Paneli këshillëdhënës ka kompetenca në gjithë territorin e Kosovës dhe për ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara të të drejtave të njeriut që janë bërë pas datës 23 prill 2005 apo që kanë rrjedh nga faktet e paraqitura para kësaj date dhe që këto fakte rrisin në vazhdimësi shkeljen e të drejtave njerëzore.

Neni 3

Kriteret për pranimin e ankesës

3.1 Paneli këshillëdhënës mund të trajtojë një çështje vetëm pasi të ketë konkluduar se janë ndjekur të gjitha rrugët tjera të mundshme për shqyrtimin e shkeljes së supozuar dhe brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga data kur është marrë vendimi i formës së prerë.

3.2 Paneli këshillëdhënës nuk shqyrton ankesën që është:

(a) anonime ose

(b) kryesisht e njëjtë me një çështje që tanimë është shqyrtuar nga Paneli këshillëdhënës dhe nuk përmban informata të reja përkatëse.

3.3 Paneli këshillëdhënës shpall si të papranueshme çdo ankesë të cilën e konsideron se nuk është në përputhshmëri me të drejtat e njeriut, të përcaktuara në një apo në më shumë instrumente të përmendura në nenin 1.2 lart dhe e konsideron si të pabazë ose shpërdorim i së drejtës së ankesës.

KAPITULLI 2: Përbërja dhe statusi i Paneli këshillëdhënës mbi të drejtat e

njeriut

Neni 4

Selia dhe përbërja

4.1 Paneli këshillëdhënës e ka selinë në Prishtinë.

4.2 Paneli këshillëdhënës përbëhet prej tre anëtarëve nga të cilët njëri emërohet kryesues. Së paku një anëtar i Panelit këshillëdhënës duhet të jetë femër.

4.3 Anëtarët e Panelit këshillëdhënës janë juristë ndërkombëtarë me karakter të lartë moral, paanshmëri dhe integritet, të dëshmuar si ekspertë në fushën e të drejtave të njeriut, në veçanti në sistemin evropian.

Neni 5

Emërimi i anëtarëve

5.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e Panelit këshillëdhënës pas propozimit të bërë nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5.2 Anëtarët emërohen me mandat dy (2) vjeçar. Emërimi mund të vazhdohet edhe për një mandat tjetër dyvjeçar (2).

Neni 6

Dhënia e betimit solemn

Me rastin e emërimit, çdo anëtar i Panelit këshillëdhënës e nënshkruan deklaratën në vijim para Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose para personit të caktuar nga ai:

“Solemnisht deklaroj se:

“Do t’i përmbahem ligjit gjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksioneve në postin tim dhe do të veproj në pajtim me standardet më të larta profesionale e respektin më të lartë ndaj dinjitetit të postit tim dhe detyrave që më janë besuar.

Në ushtrimin e funksioneve të postit tim gjithmonë do të mbështes standardet më të larta të pranuara ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut, përfshirë ato të paraqitura në parimet e Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, në Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese dhe në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve”.

Neni 7

Imuniteti dhe pacenueshmëria

7.1 Zyrat e shfrytëzuara nga Paneli këshillëdhënës janë të pacenueshme. Arkivi, lëndët, dokumentet, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Panelit këshillëdhënës kudo që të vendosen dhe nga kushdo që të mbahen janë të pacenueshme dhe të mbrojtura nga bastisja, marrja, sekuestrimi, konfiskimi, shpronësimi ose nga çfarëdo forme tjetër e ndërhyrjes përmes veprimit ekzekutiv, administrativ, gjyqësor a legjislativ.

7.2 Anëtarët e Panelit këshillëdhënës kanë imunitet të njëjtë si personeli i UNMIK-ut sipas neneve 3.3 dhe 3.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë.

7.3 Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë dhe përgjegjësi t'ia heqë imunitetin e anëtarit të Panelit këshillëdhënës në çdo rast që, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengojë rrjedhat e drejtësisë dhe ai mund të hiqet pa cenuar interesat e UNMIK-ut.

Neni 8

Burimet financiare dhe njerëzore

Për funksionimin efikas të Panelit këshillëdhënës merren masat e duhura përmes sigurimit të burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore.

Neni 9

Sekretariati

Panelit këshillëdhënës ka sekretariatit me orar të plotë.

KAPITULLI 3: Procedura e punës së Panelit këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 10

Parashtrimi i ankesave dhe përfaqësuesit sipas detyrës zyrtare

12.1 Komunikimet ndërmjet Panelit këshillëdhënës dhe ankuesit ose personit që vepron në emër të tij janë të fshehta.

12.2 Fshtësia e komunikimit siç paraqitet në nenin 12.1 zbatohet në tërësi kur ankuesi ose personi që vepron në emër të tij është në paraburgim.

Neni 11

Parashtresat me shkrim

11.1 Ankesa paraqet të gjitha faktet e rëndësishme mbi të cilat bazohet shkelja e supozuar e të drejtave të njeriut. Ankesës mund t'i bashkëngjiten edhe dokumente të tjera si dëshmi.

11.2 Pas marrjes së ankesës Paneli këshillëdhënës përcakton se a është ankesa e pranueshme. Nëse informacionet e dhëna me ankesën nuk mundësojnë që të bëhet një konstatim i tillë, Paneli këshillëdhënës kërkon informacione shtesë nga ankuesi. Nëse Paneli këshillëdhënës konstaton se ankesa është e papranueshme, ai merr vendim me të cilin refuzohet ankesa.

11.3 Kur Paneli këshillëdhënës konstaton se ankesa është e pranueshme, ai ia referon ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në mënyrë që të merret një përgjigje në emër të UNMIK-ut lidhur me ankesën. Përgjigja e tillë i jepet Panelit këshillëdhënës brenda njëzet (20) ditësh nga dita e pranimit të ankesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

11.4 Paneli mund të kërkojë nga ankuesi dhe UNMIK-u që të bëjnë parashtresa tjera me shkrim brenda afateve kohore që ai mund t'i caktojë nëse këto parashtresa janë në interes të drejtësisë.

Neni 12

Fshehtësia e komunikimeve

12.1 Komunikimet ndërmjet Panelit këshillëdhënës dhe ankuesit ose personit që vepron në emër të tij janë të fshehta.

12.2 Fshehtësia e komunikimit siç paraqitet në nenin 12.1 zbatohet në tërësi kur ankuesi ose personi që vepron në emër të tij është në paraburgim.

Neni 13

Pjesëmarrja e një *Amicus Curiae* dhe e avokatit të popullit

13.1 Paneli këshillëdhënës, kur është në interes të drejtësisë, mund të ftojë

- (a) Një *amicus curiae* që të parashtrorë komentet me shkrim dhe
- (b) Avokatin e popullit që të parashtrorë komentet me shkrim nëse ai është duke u marrë me këtë çështje.

13.2 Parashtresat me shkrim nga avokati i popullit do të jenë pa paragjykime mbi autorizimet, përgjegjësitë dhe obligimet e avokatit të popullit sipas ligjit në fuqi.

Neni 14

Seancat verbale

Kur është në interes të drejtësisë Paneli këshillëdhënës mban seanca verbale.

Neni 15

Kërkesat për paraqitjen e personave ose për parashtrimin e dokumenteve

15.1 Paneli këshillëdhënës mund të kërkojë paraqitjen e çdo personi, përfshirë edhe personelin e UNMIK-ut, ose parashtrimin e çdo dokumenti, përfshirë dosjet dhe dokumentet që i posedon UNMIK-u, të cilat mund të jenë të rëndësishme për ankesën.

15.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm bashkëpunon me Panelin këshillëdhënës dhe i ofron atij ndihmën e nevojshme gjatë ushtrimit të pushtetit dhe kompetencave të tij në mënyrë të veçantë për lëshimin e dokumenteve dhe informatave që janë të rëndësishme për ankesën..

15.3 Kërkesat për paraqitjen e personelit të UNMIK-ut ose për parashtrimin e dokumenteve të Kombeve të Bashkuara i bëhen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Gjatë marrjes së vendimit për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm merr parasysh interesin e drejtësisë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe interesat e përgjithshme të UNMIK-ut e të Kombeve të Bashkuara.

Neni 16

Seancat publike dhe qasja në dokumentet e deponuara në Panelin këshillëdhënës

16.1 Seancat e Panelit këshillëdhënës janë publike përveç në rastet e jashtëzakonshme kur Paneli këshillëdhënës vendos ndryshe.

16.2 Pas miratimit nga Paneli këshillëdhënës, dokumentet e deponuara në Panelin këshillëdhënës për të drejtat e njeriut mund t'i vihen në dispozicion çdo personi që ka interes të ligjshëm në çështjen pas paraqitjes së kërkesës me shkrim.

Neni 17

Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshillëdhënës

17.1 Paneli këshillëdhënës sjell konkludimet mbi atë se a ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut dhe, kur është e nevojshme, bën rekomandime. Këto konkludime dhe çdo rekomandim i Panelit këshillëdhënës i parashtrihen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

17.2 Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshillëdhënës botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjerë dhe qasje në to.

17.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ushtron pushtetin dhe diskrecionin ekskluziv për të vendosur se a duhet vepruar sipas konkludimeve të Panelit këshillëdhënës.

17.4 Vendimet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjerë dhe qasje në to.

Neni 18
Rregullorja e punës

18.1 Paneli këshillëdhënës miraton rregulloren e punës për procedurat e veta. Rregullorja e punës mund t'i japë autorizime dhe përgjegjësi sekretariatit të Panelit këshillëdhënës.

18.2 Pas miratimit nga Paneli këshillëdhënës, rregullorja e punës publikohet me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe me qëllim të shpërndarjes së gjerë dhe qasjes në to.

KAPITULLI 4: Dispozitat përfundimtare

Neni 19 Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të shpallë çdo udhëzim të nevojshëm administrativ për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 20 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 21 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 23 mars 2006, përveç nenit 10 i cili hyn në fuqi me 23 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Aneksi B:

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au
Kosovo

UNMIK/DIR/2009/1

17 tetor 2009

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2009/1

**PËR IMPLEMENTIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UR NR. 2006/12 MBI
THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLËDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 19 të Rregullores nr. 2006/12 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/3, të datës 12 janar 2007 (Rregullorja),

Duke marrë parasysh Rregulloren e Punës të miratuar më 5 shkurt 2008 nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, në pajtim me nenin 18 të Rregullores,

Me qëllim të qartësimit të karakterit dhe rregullimit të procedurave të dëgjimeve publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, shqyrtimin e pranueshmërisë së ankesave nga ky Panel dhe caktimin e një afati kohor për paraqitjen e ankesave pranë këtij Paneli, Paneli

Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, duke pasur parasysh kapacitetin e zvogëluar të UNMIK-ut që të ushtrojë autoritet ekzekutiv në mënyrë efektive në të gjitha fushat nga ku burojnë çështjet e ankesave për të drejtat e njeriut,

Me anë të kësaj nxjerr këtë Urdhëresë administrative,

Neni 1

Dëgjimet publike

1.1 Dëgjimet publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli Këshillëdhënës) do të drejtohen në mënyrën dhe përbërjen që qartazi do të lënë të kuptohet se janë procedura joadversiale dhe që do t'ju përcillen të gjithë pjesëmarrësve si dhe opinionit të gjerë publik, duke përfshirë edhe mediat e pranishme, nëse prania e tyre lejohet nga Paneli Këshillëdhënës.

1.2 Gjatë dëgjimeve publike, ankuesve apo përfaqësuesve të tyre do t'ju lejohet të bëjnë deklaratat duke përmbledhur pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut, ashtu siç është paraqitur në parashtrësën me shkrim pranë Panelit Këshillëdhënës. Gjatë dëgjimeve publike, Paneli Këshillëdhënës mund t'ju parashtojë pyetje palëve ose përfaqësuesve të tyre të cilat qartësojnë bazën faktike të ankesës, dhe që për Panelin Këshillëdhënës janë të nevojshme që në tërësi të vlerësojë pohimin për shkeljen e të drejtave të njeriut të paraqitur pranë tij.

1.3 Vendi dhe rregullimi i ulëseve për dëgjimet publike të drejtuara nga Paneli Këshillëdhënës janë në përputhje me natyrën joadversiale të procedurës.

Neni 2

Çështjet e pranueshmërisë

2.1 Në cilëndo fazë të procedurës së një ankese mbi të drejtat e njeriut të paraqitur pranë tij, Paneli Këshillëdhënës shqyrton të gjitha çështjet e pranueshmërisë së ankesës para se të shqyrtojë bazueshmërinë e rastit.

2.2 Çdo ankesë e cila është apo mund të jetë në të ardhmen çështje e procesit të ankesave të palës së tretë ose procedurave sipas nenit 7 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, do të konsiderohet e papranueshme për arsye se procesi i ankesave të palës së tretë të KB-së dhe procedura sipas nenit 7 të Rregullores nr. 2000/47 janë mjete në dispozicion sipas nenit 3.1 të Rregullores.

2.3 Pas çdo vendimi të ri mbi pranueshmërinë e rastit, Paneli Këshillëdhënës vendimin e tillë të ri ia referon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm me qëllim të marrjes së komenteve shtesë për ankesën.

Neni 3

Emërimi dhe dorëheqja e anëtarëve të Panelit

3.1 Kryetari i Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut do të propozojë një numër të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm për emërim sipas nenit 5 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2006/12, në pajtim me rregullat e zbatueshme të prokurimit të KB-së, pas marrjes së kërkesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Nëse UNMIK-u nuk merr asnjë propozim apo merr numër të pamjaftueshëm të propozimeve brenda një muaji kalendarik nga kërkesa e tillë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të bëjë emërimin e nevojshëm pa propozimin e kërkuar dhe pas konsultimeve me organet relevante ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

3.2 Nëse një apo më shumë anëtarë të Panelit Këshillëdhënës japin dorëheqje nga postet e tyre, Paneli nuk merr asnjë vendim derisa të bëhen emërimet e reja duke ia mundësuar Panelit të arrijë numrin e parashikuar të anëtarëve.

Neni 4

Publikimet e Panelit Këshillëdhënës

Të gjitha publikimet, njoftimet dhe komunikatat për shtyp të Panelit Këshillëdhënës bëhen përmes zyrës së zëdhënësit të UNMIK-ut dhe informimit publik, që e ndihmon Panelin Këshillëdhënës në njoftimet e tij zyrtare mbi të gjitha çështjet.

Neni 5

Data e prerë për parashtrimin e ankesave

Pavarësisht nga neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, asnjë ankesë dorëzuar Panelit Këshillëdhënës nuk do të jetë e pranueshme nëse pranohet nga Sekretariati i Panelit Këshillëdhënës më vonë se 31 mars 2010.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 17 tetor 2009 dhe është e zbatueshme për të gjitha ankesat e dorëzuara Panelit Këshillëdhënës, duke përfshirë edhe ato të cilat janë në pritje për t'u shqyrtuar nga Paneli Këshillëdhënës.

Lamberto Zannier

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Aneksi C:

Numri i lëndëve të PKDNJ, i komunikatave & vendimeve (nga 31 dhjetori 2012)									
Numri i lëndëve	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Total	
Të pranuara	3	12	69	353	90 ¹⁵	n/a	n/a	527	
Të mbyllura	0	0	18	11	35 ¹⁶	98	95	257	
Në pritje të zgjidhjes	3	15	66	407	459	362	270	270	
Komunikata	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Total	
Të komunikuar PSSP-së	0	0	30	71	60	117	73	351	
Përgjigjet nga PSSP-ja	0	0	18	75	30	100	104	327	
Në pritje të përgjigjes nga PSSP-ja	0	0	12	8	38	55	24	24	
Vendimet sipas llojit	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Total	
Gjithsej	0	0	32	26	84	213	270	625	
Vendimet për pranueshmëri	0	0	28	22	56	164	238	508	
Vendimet për pranueshmëri të pjesshme	0	0	2	0	1	0	0	3	
Të hequra nga lista	0	0	0	3	5	2	6	16	
Mendimet për bazueshmëri	0	0	1	0	22	46	23	92	
Mendimet e pjesshme për bazueshmërinë	0	0	0	1	0	0	0	1	
Vendimet për rishikim dhe rihapje	0	0	1	0	0	1	3	5	
Vendimet sipas gjetjeve	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Total	
Vendimet	Të pranueshme	0	0	11	2	16	63	112	204
	Pjesërisht të pranueshme	0	0	2	9	25	51	60	147 ¹⁷
	Të papranueshme	0	0	17	8	10	50	66	151
Mendimet: Shkelje	0	0	1	0	21	45	21	88	
Mendimet: Nuk ka shkelje	0	0	0	1	1	1	2	5 ¹⁸	
Kërkesat për rishqyrtim:	Të refuzuara	0	0	1	0	0	1	1	3
	Të miratuara	0	0	0	0	0	0	2	2

¹⁵ Pas shqyrtimit nga Paneli, lënda me nr. 25/10 u nda në dy lëndë (lënda e re me nr. 90/10).

¹⁶ Lëndët me nr. 04/07 dhe 26/08, që më parë ishin shpallur të papranueshme në vitin 2010, janë rihapur nga Paneli.

¹⁷ Tri nga ata, dy nga viti 2008 dhe një nga viti 2010, janë vendime të pranueshme pjesërisht.

¹⁸ Njëri prej tyre është mendim i pjesshëm mbi bazueshmërinë.

Aneksi D: Vendimet dhe mendimet e PKDNJ të nxjerra në vitin 2012 (në renditje kronologjike)

Vendimet – Të pranueshëm:

1. *Dragica Majstorović dhe Slavica Stevanović, 42/09 dhe 128/09* – vendim i 17 shkurtit 2012.
2. *Zlatibor Ljushiç dhe Zoran Ljushiç, 70/09 dhe 108/09* – vendim i 17 shkurtit 2012
3. *Radivoje Radisavljeviç, 156/09* – vendim i 17 shkurtit 2012
4. *Ivica Marković, 06/10* – vendim i 19 shkurtit 2012
5. *M. S., 110/09* – vendim i 16 marsit 2012
6. *Milisav Gogiç, 135/09* – vendim i 16 marsit 2012
7. *Radojka Shçekiç, 212/09* – vendim i 16 marsit 2012
8. *Petar Joviç, 233/09* – vendim i 17 marsit 2012
9. *Luka Anxhelkoviç, 277/09* – vendim i 5 prillit 2012
10. *Stevan Simoviç, 246/09* – vendim i 6 prillit 2012
11. *Snezhana Simonoviç, 258/09* – vendim i 10 majit 2012
12. *Zhaklina Foliç dhe të Tjerët, 58/09, 59/09, 60/09, 62/09, 215/09 dhe 217/09* – vendim i 10 majit 2012
13. *Srboljub Mitiç dhe të Tjerët, 63/09, 64/09, 65/09, 66/09, 109/09, 113/09, 162/09, 300/09 dhe 301/09* – vendim i 10 majit 2012
14. *Rosanda Kabash, 78/98* – vendim i 11 majit 2012
15. *Nedeljka Kljaiç, 80/09* – vendim i 10 majit 2012
16. *Kata Jovanoviç, 84/09* – vendim i 11 majit 2012
17. *Milusha Joshanoviç, 124/09* – vendim i 10 majit 2012
18. *Zhivka Çunguroviç, 131/09* – vendim i 10 majit 2012
19. *Marko Markoviç, 142/09* – vendim i 11 majit 2012
20. *Slavica Zogoviç, 152/09* – vendim i 10 majit 2012
21. *Momir Milenkoviç, 176/09* – vendim i 10 majit 2012
22. *Radmila Markoviç, 214/09* – vendim i 11 majit 2012
23. *Draginja Vujaçiç, 226/09* – vendim i 11 majit 2012
24. *Blagica Niçiç, 228/09* – vendim i 10 majit 2012
25. *Raza Shala, 243/09* – vendim i 11 majit 2012
26. *Vesna Çeliç, 260/09* – vendim i 11 majit 2012
27. *Jeremija Shuljiniç, 276/09* – vendim i 11 majit 2012
28. *Momçilo Voshtiç, 279/09* – vendim i 10 majit 2012
29. *Milorad Andrejeviç, 282/09* – vendim i 10 majit 2012
30. *Suzana Ljumoviç, 285/09* – vendim i 10 majit 2012
31. *Nebojsha Grujiç, 287/09* – vendim i 10 majit 2012
32. *Dushica Stojkoviç, 290/09* – vendim i 10 majit 2012
33. *Zorica Stankoviç, 304/09* – vendim i 10 majit 2012
34. *Stana Popoviç, 56/09* – vendim i 22 majit 2012
35. *Bojana Laziç, 261/09* – vendim i 9 qershorit 2009
36. *P. S., 48/09* – vendim i 9 qershorit 2012
37. *Lela Nikoliç, 72-76/09* – vendim i 21 qershorit 2012
38. *Ljubomir Aritonoviç, 136/09* – vendim i 9 qershorit 2012
39. *Sava Jovanoviç, 213/09* – vendim i 9 qershorit 2012
40. *Slobodanka Spasiç dhe të Tjerët, 221/09, 273/09 dhe 336/09* – vendim i 9 qershorit 2012

41. *Mira Bulatoviç*, 275/09 – vendim i 9 qershorit 2012
42. *R. A.*, 41/09 – vendim i 21 gushtit 2012
43. *Zhivanka Patrnogiç dhe Vesna Vojnoviç*, 143/09 dhe 247/09 – vendim i 21 gushtit 2012
44. *Ljliana Mitroviç dhe të Tjerët* 144/09, 158/09, 209/09 dhe 210/09 – vendim i 23 gushtit 2012
45. *Gordana Bucalo dhe të Tjerët* 148/09, 150/09, 151/09, 161/09 – vendim i 23 gushtit 2012
46. *Sonja Koriçanin*, 167/09, 174/09, 175/09 – vendim i 23 gushtit 2012
47. *Snezhana Milenkoviç dhe Momçilo Milenkoviç*, 168/09, 169/09, 312/09- vendim i 17 gushtit 2012
48. *Gordana Janiçieviç*, 216/09 – vendim i 17 gushtit 2012
49. *Ranko Janjiç*, 220/09 – vendim i 17 gushtit 2012
50. *Vekoslav Ristiç*, 224/09 & 225/09 – vendim i 23 gushtit 2012
51. *Z. B.*, 229/09 – vendim i 17 gushtit 2012
52. *D. Sh.*, 244/09 – vendim i 23 gushtit 2012
53. *Predrag Joksimoviç*, 283/09 – vendim i 23 gushtit 2012
54. *Marija Stevanoviç*, 289/09 – vendim i 23 gushtit 2012
55. *Bozhidar Jovanoviç, dhe të Tjerët* 293/09 – vendim i 21 gushtit 2012
56. *Verica Iliç*, 303/09 – vendim i 23 gushtit 2012
57. *Budimir Maslar*, 333/09 – vendim i 17 gushtit 2012
58. *Ru. R.*, 340/09 – vendim i 17 gushtit 2012
59. *Aleksandar and Ljubinka Markoviç*, 91/09 & 338/09 – vendim i 12 shtatorit 2012
60. *Gavrilo Milosavljeviç*, 163/09 – vendim i 12 shtatorit 2012
61. *Verica Pekiç*, 15/10 – vendim i 12 shtatorit 2012
62. *Slaxhana Remishtar*, 245/09 – vendim i 26 shtatorit 2012
63. *Dushanka Trifunoviç*, 297/09 – vendim i 26 shtatorit 2012
64. *Radoje Xhuriç*, 104/09 & 159/09 – vendim i 26 shtatorit 2012
65. *Spesa Markoviç*, 227/09 – vendim i 26 shtatorit 2012
66. *Radomir Pantoviç*, 239/09 – vendim i 26 shtatorit 2012
67. *Bljana Kuzmanoviç*, 262/09 – vendim i 26 shtatorit 2012
68. *Slobodan Shkripac*, 266/09 – vendim i 26 shtatorit 2012
69. *Milijana Vuksanoviç*, 270/09 – vendim i 26 shtatorit 2012
70. *Nedeljko Ivkoviç*, 281/09 – vendim i 26 shtatorit 2012
71. *Ljubinko Vasiç dhe Malina Vukiç*, 291/09 dhe 292/09 – vendim i 26 shtatorit 2012
72. *Bogoljub Shmigiç*, 264/09 & 265/09 – vendim i 21 nëntorit 12
73. *Ranko Milenkoviç*, 255/09 – vendim i 21 nëntorit 12
74. *Dragomir Jeliç*, 288/09 – vendim i 6 dhjetorit 2012
75. *Zlatana Milanoviç*, 339/09 – vendim i 6 dhjetorit 2012

Vendimet – Të pranueshëm pjesërisht:

1. *Bozhidarka Felegi*, 32/08 – vendim i 20 janarit 2012
2. *Olga Lajoviç*, 09/08 – vendim i 19 shkurtit 2012
3. *Vlainka Ristiç*, 269/09 – vendim i 17 shkurtit 2012
4. *Dragisha Xhurashkoviç*, 41/08 – vendim i 16 marsit 2012
5. *Svetlana Marinkoviç*, 203/09 – vendim i 16 marsit 2012
6. *Vesna Antiç*, 100/09 – vendim i 15 prillit 2012
7. *Radmila Tomiç*, 160/09 – vendim i 5 prillit 2012

8. *M.S. dhe të Tjerët, 122/09, 157/09, 184/09, 192/09, 193/09, 202/09, 204/09, 337/09, 347/09, 348/09, dhe 66/10* – vendim i 5 prillit 2012
9. *Dijana Zhivkoviç, 71/09* – vendim i 10 majit 2012
10. *Anka Cvijanoviç, 170/09* – vendim i 11 majit 2012
11. *Nenad Mladenoviç, 171/09* – vendim i 11 majit 2012
12. *Olivera Budimir, 219/09* – vendim i 11 majit 2012
13. *Marija Laliç, 31/08* – vendim i 10 qershorit 2012
14. *Desanka Stanishiç dhe Zoran Stanishiç, 34/08* – vendim i 21 qershorit 2012
15. *Muharem Ibraj, 14/09, 15/09, 18/09, 19/09, 20/09* – vendim i 9 qershorit 2012
16. *Zvonimir Ristiç, 10/08* – vendim i 22 gushtit 2012
17. *Bogoljub Kostić dhe të Tjerët 111/09, 117/09, 178/09, 179/09, 180/09, 230/09, 231/09, 232/09, 240/09, 241/09, 253/09, 254/09, 263/09, 284/09 dhe 286/09* – vendim i 17 gushtit 2012
18. *B.K., 85/10* – vendim i 22 gushtit 2012
19. *Budimirka Miriç et al, 68/09, 83/09, 235/09, 236/09 & 256/09* – vendim i 17 gushtit 2012
20. *Lidija Milenkoviç, 153/09 & 181/09* – vendim i 17 gushtit 2012
21. *Stanoje Ristiç, 343/09 & 344/09, Grupi XXXI* – vendim i 17 gushtit 2012
22. *Petra Kostić, 194/09* – vendim i 16 shtatorit 2012
23. *Kenan Çeliç dhe Enver Fazlija, 51/09 & 53/09* – vendim i 26 shtatorit 2012
24. *Nevenka Ristiç, 319/09* – vendim i 26 shtatorit 2012
25. *T. P., 88/10* – vendim i 27 shtatorit 2012
26. *Vladimir Manohin, 27/09* – vendim i 6 dhjetorit 2012
27. *Snezhana Markoviç, 349/09* – vendim i 6 dhjetorit 2012

Vendimet – Të papranueshëm:

1. *Dane Trboviç, 10/10* – vendim i 20 janarit 2012
2. *Novica Jovanoviç dhe të Tjerët, 28/10, 70/10, 73/10, 76/10 dhe 77/10* – vendim i 20 janarit 2012
3. *Tomislav Jovanoviç, 53/10* – vendim i 20 janarit 2012
4. *Nenad Milentijeviç, 23/10* – vendim i 17 shkurtit 2012
5. *Slavisha Dobrosavljeviç dhe të Tjerët, 26/10, 39/10 dhe 83/10* – vendim i 17 shkurtit 2012
6. *Dragan Stojanoviç dhe të Tjerët, 27/10, 41/10, 44/10 dhe 46/10* – vendim i 17 shkurtit 2012
7. *Milutin Bojkoviç, 42/10* – vendim i 17 shkurtit 2012
8. *Nebojsa Koshanin, 52/10* – vendim i 17 shkurtit 2012
9. *Javorka Miliçeviç, 346/09* – vendim i 16 marsit 2012
10. *Vesna Bojkoviç, 40/10* – vendim i 16 marsit 2012
11. *Zurap Ibrahim, 86/10* – vendim i 16 marsit 2012
12. *Slavica Dimiç, 87/10* – vendim i 16 marsit 2012
13. *Ljiliana Shljiviç-Çeaniç, 197/09* – vendim i 5 prillit 2012
14. *Nada Mladenoviç, 61/10* – vendim i 6 prillit 2012
15. *Bajram Butaja, 82/10* – vendim i 6 prillit 2012
16. *Dragan Kalaba, 84/10* – vendim i 6 prillit 2012
17. *R. Sh., 82/09* – vendim i 11 majit 2012

18. *Radmila Markoviç, 187/09* – vendim i 11 majit 2012
19. *Veska Majmareviç, 324/09* – vendim i 10 majit 2012
20. *Zorica Bojkoviç, 79/10 dhe Dejan Bojkoviç, 80/09* – vendim i 11 majit 2012
21. *Svetislav and Stana Krstiç, 49/08 & 50/08* – vendim i 9 qershorit 2012
22. *Linda, LLC, 45/08* – vendim i 22 gushtit 2012
23. *Radoslav Dekiç dhe Xhevahire Morina, 36/09 & 37/09* – vendim i 21 gushtit 2012
24. *Faik Jashari, 119/09* – vendim i 17 gushtit 2012
25. *Dragomir Jeliç, 185/09* – vendim i 17 gushtit 2012
26. *Zlatibor Ljushiç, 196/09* – vendim i 17 gushtit 2012
27. *Bozhidarka Buha, 243/09* – vendim i 17 gushtit 2012
28. *Mira Bulatoviç, 274/09* – vendim i 22 gushtit 2012
29. *H. H., 295/09* – vendim i 17 gushtit 2012
30. *Milosh Jokiç, 322/09* – vendim i 22 gushtit 2012
31. *M. N., 01/10* – vendim i 22 gushtit 2012
32. *Florije Pervizaj, 12/10* – vendim i 17 gushtit 2012
33. *Çedomila Radoviç, 19/10* – vendim i 22 gushtit 2012
34. *D. V., 24/10* – vendim i 17 gushtit 2012
35. *Lj. N., 89/10* – vendim i 22 gushtit 2012
36. *Ismet dhe Bahri Hoxha, 306/09* – vendim i 12 shtatorit 2012
37. *Nadica Vojnoviç, 29/09* – vendim i 26 shtatorit 2012
38. *N. L., 298/09* – vendim i 26 shtatorit 2012
39. *Dushanka Dodiç, 90/10* – vendim i 26 shtatorit 2012
40. *Urosh Baraç, 149/09* – vendim i 1 tetorit 2012
41. *Biljana Kuzmanoviç, 195/09* – vendim i 21 nëntorit 2012
42. *Verica Niçetiç, 199/09* – vendim i 21 nëntorit 2012
43. *Kata Jovanoviç, 200/09* – vendim i 21 nëntorit 2012
44. *Khurxhana Laziç, 201/09* – vendim i 21 nëntorit 2012
45. *Osman Ramadani dhe të Tjerët, 307/09 & 309/09* – vendim i 21 nëntorit 2012
46. *Dushanka Dodiç, 25/10* – vendim i 21 nëntorit 2012
47. *B. D., 129/09* – vendim i 6 dhjetorit 2012
48. *Verica Tomanoviç, 191/09* – vendim i 6 dhjetorit 2012
49. *Velibor Jokiç, 323/09* – vendim i 6 dhjetorit 2012
50. *Katarina Arsiç, 18/10* – vendim i 6 dhjetorit 2012
51. *Slavica Dimiç dhe Ivan Xhoshiç, 56/10 dhe 60/10* – vendim i 6 dhjetorit 2012
52. *NTP Bujari (AS Petrol), 311/09* – vendim i 6 dhjetorit 2012
53. *Jasmina Adzhiç, 75/10* – vendim i 6 dhjetorit 2012

Vendimet për largim nga lista:

1. *Vladimir Shçepanoviç, 271/09* – vendim i 17 shkurtit 2012
2. *Radomir Pantoviç, 188/09* – vendim i 16 marsit 2012
3. *Radomir Pantoviç, 189/09* – vendim i 16 marsit 2012
4. *Radojka Shçekiç, 211/09* – vendim i 16 marsit 2012
5. *Angelina Kostiç, 134/09 dhe 259/09* – vendim i 17 gushtit 2012

Vendimet për kërkesat për rihapje të procedurës:

1. *Mon Balaj dhe të Tjerët, 04/07* – vendim për rihapje të procedurës, pranohet, miratuar më 11 maj 2012
2. *N.M. dhe të Tjerët, 26/08* – vendim për rihapje të procedurës, pranohet, miratuar më 10 qershor 2012
3. *Dane Trboviç, 10/10* – vendim për rihapje të procedurës, hidhet poshtë, miratuar më 27 shtator 2012


Mendimet – Në të cilët është konstatuar shkelje:

1. *Dragan Preleviç, 11/08* – mendim i 17 shkurtit 2012
2. *Jahja Morina, 36/08* – mendim i 10 majit 2012
3. *Olga Lajoviç, 09/08* – mendim i 9 qershorit 2012
4. *Dragisha Xhurashkoviç, 41/08* – mendim i 9 qershorit 2012
5. *M. S., 122/09* – mendim i 9 qershorit 2012
6. *Radivoje Radisavljeviç 157/09* – mendim i 9 qershorit 2012
7. *Olivera Çupiç, 184/09* – mendim i 9 qershorit 2012
8. *Bogoljub Shmigiç, 192/09* – mendim i 9 qershorit 2012
9. *Milijana Vuksanoviç, 193/09* – mendim i 9 qershorit 2012
10. *Milan Petroviç, 204/09* – mendim i 9 qershorit 2012
11. *Vinka Popoviç, 337/09* – mendim i 9 qershorit 2012
12. *Predrag Miriç, 347/09* – mendim i 9 qershorit 2012
13. *Zoran Ljushiç, 348/09* – mendim i 9 qershorit 2012
14. *Slobodan Pelisher, 66/10* – mendim i 9 qershorit 2012
15. *Bozhidarka Felegi, 32/08* – mendim i 17 gushtit 2012
16. *Dragan Piljeviç, 05/09* – mendim i 17 gushtit 2012
17. *Svetlana Marinkoviç, 203/09* – mendim i 17 gushtit 2012
18. *Velibor Axhançiç, 310/09* – mendim i 17 gushtit 2012
19. *Gani Thaqi, 13/08* – mendim i 12 shtatorit 2012
20. *S. C., 02/09* – mendim i 6 dhjetorit 2012
21. *Zvonimir Ristiç, 10/08* – mendimi i 6 dhjetorit 2012


Mendimet – Në të cilët nuk është konstatuar shkelje:

22. *Miroslav Mihajloviç, 15/08* – mendim i 22 gushtit 2012
23. *Desanka Stanishiç dhe Zoran Stanishiç, 34/08* – mendim i 22 gushtit 2012

Aneksi E:



Aneksi F:



Aneksi G:

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

DOJ – DD – Departamenti i Drejtësisë

DPPO - PPQ- Prokuroria Publike e Qarkut

ECHR - KEDNJ- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

ECtHR - GJDNJ- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

EU – BE – Bashkimi Evropian

EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë për Sundimin e Ligjit

HPCC – KAÇBP – Komisioni i Ankesave për Çështje Banesore Pronësore

HPD – DÇBP – Drejtoria për Çështje Banesore Pronësore

HRAP - PKDNJ- Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

HRC – KDNJ – Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut

IACTHR – GJNADNJ- Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut

ICCPR – KNDCP – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike

ICMP – KNPZH – Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur

ICRC – KNKK- Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq

JSEC – KPES – Komiteti I Përbashkët Ekzekutiv për Siguri

KFOR – Forca e Sigurisë Ndërkombëtare (e njohur përgjithësisht si Forca e Kosovës)

KPA – AKP – Agjencia Kosovare e Pronës

KPC – TMK – Trupat Mbrojtëse të Kosovës

KTA – AKM- Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

KLA – UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës

MMP – PZHV – Person i Zhdukur/i Vrarë

OMPF – ZPZHML – Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore

OSCE – OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PAK – AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit

SOE – NPSH – Ndërmarrje në Pronësi Shoqërore

SRSG – PSSP- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

UN – KB- Kombet e Bashkuara

UNDP – PKBZH Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNHCR – Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë

UNMIK – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë